


Kumbona e së Diellës



James Tissot - Tundimi i Jezu Krishtit, 1886-1894.

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.1/2, Janar - Shkurt 2018



ILAÇET KRESHMORE: LUTJA, LËMOSHA E AGJËRIMI

Nëse i shikojmë brenda nesh e rreth nesh këto sinjale - shkruan Françesku - Kisha na ofron, në kohën e Kreshmëve “ilaçin e lutjes, të lëmoshës e të agjërimit”.

Me lutjen “e ndihmojmë zemrën tonë t'i zbulojë mashtrimet” me të cilat gënjejmë vetveten

Lëmosha, që na çliron nga lakmia, duhet të bëhet për të gjithë stil i vërtetë jete. Sa do të dëshiroja - pohon Papa - që përballë çdo vëllai, në kërkim të ndihmës, të mendonim se “aty është thirrja e Provanisë hyjnore”. Në të vërtetë, nëse Zoti sot shërbehet nga unë për të ndihmuar një vëlla, si mundet, nesër, të mos mendojë edhe për nevojat e mia?

Agjërimi, në fund, na çarmatos, na bën të rritemi, na zgjon, na bën më të vëmendshëm ndaj Zotit e ndaj të afërmit dhe e forcon vullnetin për ta dëgjuar zërin e Zotit, i vetmi që mund ta shuajë vërtetë urinë dhe etjen tonë!

24 orë për Zotin, adhurim e pajtim!

Papa u bën thirrje edhe jo katolikëve, të gatshëm për ta dëgjuar zërin e Zotit: “Nëse, si ne, jeni të lodhur nga përhapja e padrejtësisë, që ka marrë dhënë - shkruan - nëse ju shqetëson ngrica, që paralizon zemrat e veprimet, nëse shikoni se mungon kuptimi i një njerëzimi të vetëm, bashkohuni me ne për t'iu lutur së bashku Zotit, për të agjëruar së bashku me ne e për të dhuruar, sipas mundësisë, lëmoshë në ndihmë të vëllezërve”.

E, për anëtarët e Kishës, rast për të rifilluar të duan, do të jetë - kujton Françesku - nisma “24 orë për Zotin”: në çdo dioqezë, ndërmjet së premtës dhe së shtunës, 10 mars, së paku një kishë do të jetë e hapur gjithë ditën për adhurim e rrëfim.

Kështu, Natën e Pashkëve - përfundon Papa - drita e qiriut të Solemnitetit, do ta dëbojë me të vërtetë errësirën dhe dëgjimi i Fjalës së Zotit, me shujtën e Bukës eukaristike, do të ndezë në zemrën tonë fenë, shpresën e dashurinë”.



Redaksia	4
MESAZHI I KRESHMEVE 2018	
Papa Françesko	7
TË BESOSH NË PREMTIMIN QË TË KA BËRË ZOTI	
CCEE	9
VËLLAZËRIA PËRMES PËRSHPIRTËRISË	
Dom Lush Gjergji	11
CARLO CARRETTO	
Dom Nosh Gjollaj	14
PUSHIMI DHE UDHTIMI I PROGRAMUAR	
Eugjen Merlika	18
PORTALËT QË MË QUAJNË HERETIK	
Ireneo, Ilario, Cesario Dominique Bertrand S.I	20
ORIGINALITETI I NJË TRADITE	
Leonora Laçi	24
SI I SHPËTOJ SIGURIMIT MONS.DR. ZEF OROSHI	
Redaksia	26
SHQIPËRIA DHE SELIA E SHENJTË	
Redaksia	27
SHËN PATRIKU	
VITRINA E LIBRIT	28

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXI, nr. 1/2 (503-504) Janar - Shkurt 2018

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Vlash Palaj
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
nike.ukgjini@gmail.com
Web page: kishakatolikeshkoder.com
Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

MESAZHI I KRESHMEVE 2018


**“Ngase do të marrë hov padrejtësia, shumëkujt do t'i ftohet dashuria”
(Mt 24,12)**

Të dashur vëllezër e motra,

edhe një herë na dalin përpara Pashkët e Zotit! Për t'u përgatitur për të Provania e Hyjit na dhuron çdo vit Kreshmët, “shenjë sakramentale e kthimit tonë”, që shpall dhe realizon mundësinë për t'u kthyer nga Zoti me gjithë zemër dhe me gjithë jetën.

Edhe këtë vit, me këtë mesazh, dëshiroj të ndihmoj gjithë Kishën që të jetojë me gëzim e të vërtetë në këtë kohë hiri; dhe e bëj këtë duke u frymëzuar prej një shprehjeje të Jezusit në Ungjillin e Mateut: “Ngase do të marrë hov padrejtësia, shumëkujt do t'i ftohet dashuria” (24,12).

Kjo fjali gjendet në fjalimin që ka lidhje me fundin e kohëve dhe që është i ambientuar në Jerusalem, në Malin e Ullinjve, pikërisht aty ku do të fillojnë mundimet e Zotit. Duke iu përgjigjur një pyetjeje të nxënësve, Jezusi shpall mundime të mëdha dhe përshkruan situatën në të cilën mund të gjendet bashkësia e besimtarëve: përballë ngjarjeve të dhimbshme, disa profetë të rrejshëm do të gënjejnë shumë vetë, aq sa të kërcënojnë ta shuajnë në zemrat dashurinë që është qendra e të gjithë Ungjillit.

**Profetët e rrejshëm**

Le ta dëgjojmë këtë pjesë dhe të pyesim veten: çfarë formash marrin profetët e rrejshëm?

Ata janë si “magjepsës gjarpërinjsh”, pra përfitojnë nga emocionet njerëzore për t'i bërë njerëzit skllevër dhe për t'i çuar aty ku duan ata. Sa bij të Hyjit tërhiqen prej joshjeve të kënaqësisë në pak çaste, kënaqësi të cilën e ngatërrojnë me lumturinë! Sa burra e gra jetojnë si të magjepsur nga iluzioni i parave, që në të vërtetë i bën skllevër të përfitimit ose të interesave mesquine! Sa vetë jetojnë duke menduar se i mjaftojnë vetvetes dhe bien pre e vetmisë!

Profetë të tjerë të rrejshëm janë ata “sharlatanë” që ofrojnë zgjidhje të thjeshta e të menjëhershme për vuajtjet, mjete që pastaj dëftohen krejtësisht jo efikase: sa të rinjve u ofrohet mjeti i rrejshëm i drogës, i marrëdhënieve “përdor e hidh”, i fitimeve të lehta por të pandershme! Sa vetë janë ende në rrjetën e një jete krejtësisht virtuale, në të cilën marrëdhëniet duken më të thjeshta e të shpejta e që pastaj dëftohen dramatikisht pa kuptim! Këta mashtrues, që ofrojnë gjëra pa vlerë, heqin në të

vërtetë atë që është më e çmueshme sikurse dinjiteti, liria dhe aftësia për të dashur. Është mashtrimi i mburrjes, që na bën të bëjmë figurën e pallonjve... për t'u bërë pastaj qesharakë; dhe prej gjendjes qesharake nuk mund të kthehesh prapa. Nuk është për t'u çuditur: gjithmonë djalli, që është “rrenacak dhe babai i rrenës” (Gjn 8,44), e paraqet të keqen si të mirë dhe të remen si të vërtetë, për ta pështjelluar zemrën e njeriut. Prandaj secili prej nesh është i thirrur të shohisë në zemrën e vet dhe të shqyrtojë nëse është i kërcënuar prej rrenave të këtyre profetëve të rremë. Duhet të mësojmë të mos ndalemi në nivelin e drejtpërdrejtë, sipërfaqësor, por ta njohim atë që lë brenda nesh një gjurmë të mirë dhe që zgjat më shumë, sepse vjen prej Hyjit dhe vlen me të vërtetë për të mirën tonë.

Një zemër e ftohtë

Dante Alighieri, në përshkrimin e tij të ferrit, e përfytyron djallin të ulur në një fron prej akulli; ai banon në ngricën e dashurisë



së mbytur. Atëherë le ta pyesim veten: si ftohet në ne dashuria? Cilat janë sinjalet që na tregojnë se në ne dashuria rrezikon të shuhet?

Ajo që e shuan dashurinë është para së gjithash grykësia për paratë, “rrënja e të gjitha të këqijave” (1 Tim 6,10); atë e ndjek refuzimi i Hyjit dhe prandaj edhe refuzimi për të gjetur ngushëllim në Të, duke parapëlqyer pikëllimin tonë në vend të Fjalës së tij dhe Sakramenteve. E gjithë kjo shndërrohet në dhunë dhe kthehet kundër atyre që konsiderohen si kërcënim për “siguritë” tona: fëmija ende i palindur, i moshuari i sëmurë, mysafiri në kalim, i huaji, por edhe i afërmi që nuk u përgjigjet pritshmërive tona.

Edhe bota e krijuar është dëshmitare e heshtur e kësaj ftohjeje të dashurisë: toka është e helmuar nga mbeturinat e hedhura prej pakujdesit dhe mosinteresit; detet, edhe ato të ndotura, mjerisht duhet të mbulojnë kufomat e shumë të mbyturve të migrimeve të detyruara; qiejt – që në planin e Hyjit i këndojnë lavdisë së tij – janë të mbushur plot me mjete fluturuese që e hedhin si shi vdekjen

Dashuria ftohet edhe në bashkësitë tona: në Nxitjen apostolike Evangelii gaudium jam munduar të përshkruaj shenjat më të dukshme të kësaj mungese dashurie. Ato janë: përtesa egoiste, pesimizmi i shterpë, tundimi për t'u izoluar dhe për t'u angazhuar në luftëra të vazhdueshme vëllavrasëse, mendësia e botës që i nxit njerëzit të merren vetëm me atë që është e dukshme, duke e pakësuar në këtë mënyrë zellin misionar.

Çfarë duhet bërë?

Nëse shohim në brendësinë tonë dhe përreth nesh sinjalet e sapo përshkruara, ja që Kisha, nëna dhe mësuesja jonë, së bashku me ilačin, nganjëherë të hidhur, na jep në këtë kohë të Kreshmëve mjetin e ëmbël të lutjes, të lëmoshës dhe të agjërimit.

Duke i kushtuar më shumë kohë lutjes, i lejojmë zemrës sonë të zbulojë gënjeshttrat e thjeshta me të cilat mashtrojmë vetveten, për të kërkuar më në fund ngushëllimin në Hyjin. Ai është Ati ynë dhe dëshiron për ne jetën.

Ushtrimi i lëmoshës na liron prej lakmisë dhe na ndihmon të zbulojmë se tjetri është vëlla i imi: ajo që kam nuk është kurrë vetëm e imja. Sa do të doja që lëmosha të shndërrohej për të gjithë në një stil të vërtetë jete! Sa do të doja që, si të krishterë, të ndiqnim shembullin e Apostujve dhe të shihnim në mundësinë për të bashkëndarë me të tjerët të mirat tona një dëshmi konkrete të bashkimit që jetojmë në Kishë. Në lidhje me këtë po e bëj timen nxitjen e shën Palit, kur i ftonë Korintianët të mblidhnin lëmoshë për bashkësinë e Jeruzalemit: “Ju ka hije juve” (2 Kor 8,10). Kjo vlen në mënyrë të veçantë për Kreshmë, gjatë të cilave shumë organizma mbledhin lëmoshë në dobi të Kishave dhe popullsisë në vështirësi. Por sa do të doja që edhe në marrëdhëniet tona të përditshme, para çdo vëllai që na kërkon një ndihmë, ne të mendonim se aty ka një thirrje të Provanisë hyjnore: çdo lëmoshë është një rast për të marrë pjesë në Provaninë e Hyjit ndaj bijve të tij; dhe nëse Ai sot më përdor mua për të ndihmuar një vëlla, si vallë nesër nuk do të kujdeset edhe për nevojat e mia, Ai që nuk lejon t’ia kalojë kush në bujari?

Së fundi, agjërimi i heq forcë dhunës sonë, na çarmatos, dhe përbën një rast të rëndësishëm rritjeje. Nga njëra anë, na lejon të përjetojmë atë që

ndiejnë ata të cilëve u mungojnë gjërat më të nevojshme dhe njohin gërryerjet e përditshme të urisë; nga ana tjetër, shpreh gjendjen e shpirtit tonë, të uritur për mirësi dhe të etur për jetën e Hyjit. Agjërimi na zgjon, na bën më të vëmendshëm ndaj Hyjit dhe ndaj të afërmit, rizgjon vullnetin për t’iu bindur Hyjit i cili është i vetmi që e shuan urinë tonë.

Do të doja që zëri im të shkonte përtej kufijve të Kishës Katolike, për të arritur tek të gjithë ju, burra e gra vullnetmirë, të hapur ndaj dëgjimit të Hyjit. Nëse sikurse ne jeni të brengosur nga marrja hov e padrejtësisë në botë, nëse ju shqetëson ngrica që paralizon zemrat dhe veprimet, nëse shihni se është duke munguar ndjenja e njerëzimit të përbashkët, bashkohuni me ne për t’iu lutur së bashku Hyjit, për të agjëruar së bashku dhe për të dhuruar së bashku me ne sa mundeni për të ndihmuar vëllezërit!

Zjarri i Pashkëve

Ftoj sidomos anëtarët e Kishës që të ndërmarrin me zell ecjen e Kreshmëve, të mbështetur prej lëmoshës, prej agjërit dhe prej lutjes. Nëse nganjëherë dashuria duket se është duke u shuar në shumë zemra, ajo nuk shuhet në zemrën e Hyjit! Ai

na jep gjithmonë raste të reja që të mund të rifillojmë të duam. Një rast i volitshëm do të jetë edhe këtë vit nisma “24 orë për Zotin”, që na fton të kremtojmë Sakramentin e Pajtimin në një kontekst adhurimi eukaristik. Në vitin 2018 ajo do të zhvillohet të premten më 9 dhe të shtunën më 10 mars, duke u frymëzuar prej fjalëve të Psalmi 130,4: “Tek ti gjendet falja”. Në çdo dioqezë, të paktën një kishë do të rrijë hapur për 24 orë rresht, duke dhënë mundësinë e lutjes së adhurimit dhe të Rrëfimit sakramental. Natën e Pashkëve do të rijetojmë ritin e mrekullueshëm të ndezjes së qiriut pashkor: e marrur nga “zjarri i ri”, drita pak nga pak do ta dëbojë errësirën dhe do ta ndriçojë asamblenë liturgjike. “Drita e Krishtit të ngjallur në lavdi i shpërndaftë errësirat e zemrës dhe të mendjes”, që të gjithë të mund të rijetojmë përvojën e nxënësve të Emausit: nëse dëgjojmë fjalën e Zotit dhe ushqehemi me Bukën eukaristike zemra jonë do të digjet përsëri prej fesë, shpresës dhe dashurisë.

Ju bekoj me gjithë zemër dhe lutem për ju. Mos harroni të luteni për mua.



PAPA FRANÇESKO

TË BESOSH NË PREMTIMIN QË TË KA BËRË ZOTI



Të gjithë duhet të kemi ADN e Abrahamit, babait të besimit dhe të jetojmë me stilin e të qenit i singertë dhe gjithnjë në lëvizje, duke mos kërkuar gjithnjë rehatinë tonë, por të kemi kapacitetin të flasim mirë për të gjithë. Të jemi të sigurt që nuk ekziston horoskopi, apo manovrimet për të zbuluar fatin, pasi duhet të kemi besim në premtimin e Zotit. Ja cilat janë koordinatat e thjeshta të drejtimit të krishterë që papa Francesco na ka propozuar:

Ai fillimisht na flet për Abrahamin, familjen tonë dhe rreth fillimeve të popullit të krishterë. “Abrahami,- na thotë, - është babai ynë”. Pikërisht, mënyra sesi është thirrur Abrahami shënjon edhe stilin e jetës së krishterë. Abrahami i përgjigjet pyetjes sesi duhet të jetë një i krishterë duke thënë se nëse ti do, është krejt e thjeshtë, shko në kishë, lexo këto fjalë dhe do të gesh stilin që të duhet. Një stil që gjendet në Ungjijtë. Siç në farë ka ADN-në e frytit që do të vijë më vonë, kështu tek Abrahami është i rrënjësor stili i jetës së krishterë, i stilit tonë si pjesë e një populli.

“Dimensioni i parë i këtij stili është “zhveshja”, - na ka bërë të ditur papa. Fjala e parë që Zoti i thotë Abrahamit është “Shko!”. Pra, të jesh i krishterë na

sjell gjithnjë në mendje këtë dimensionin e “zhveshjes”, që e ka bazën në zhveshjen që ka bërë Jezusi në kryq. Kështu kur dëshirojmë të hedhim hapin e parë do të kemi gjithnjë një: “Lësho dhe largohu nga toka jote, nga kushërinjtë, nga shtëpia e prindërve të tu! » - është kjo komanda që Zoti i jep Abrahamit.

“Por nëse kujtohem, - vazhdon papa,- në Ungjij thirrja e dishepujve është një “Largohu !”, “ Lësho !”, “ Eja !”. Kështu, ndër profetë mendojmë për Eliseon, i cili po punon tokën: “Lëshoje dhe eja”. “Por të p a k t ë n m ë l ë r q ë t ë përshëndetem me prindërit e mi” –thotë ai. “Por, ti shko tek ato dhe kthehu tek unë” – i përgjigjet Zoti. Është gjithnjë

stili: “Lësho gjithçka dhe eja”.

“Një i krishterë duhet të ketë këtë aftësi, që të “zhvishet” - ka nënvizuar prapë papa. Në të kundërt, nuk ka të krishterë të vërtetë, pasi sigurisht nuk janë të krishterë ato që nuk e lënë vetën të lirë që të “zhvishen” dhe të kryqëzohen me Jezusin në kryq, siç ka bërë për shembull Shenjti Paolo. Abrahami thotë “Letrën e Hebrenjve”, për besimin dhe bindjen, për atë që ec në një botë që nuk di nga t'ia nisi dhe ku duhej të shkojë. Për një të krishterë nuk ka horoskop për të parë të ardhmen, ai nuk shkon tek një shtrigë me sferë të kristaltë, apo tek një fallxhor që ia lexon dorën. E vërtetë, ai nuk e di se ku shkon, por udhëhiqet.

“Zhveshja”, pra, është si një matje e parë për jetën tonë të krishterë. Edhe pse një gjë e tillë? Për një asketizëm të ndalur ? Jo, por për të shkuar drejt një premtimi. Dhe ja pra, cilësia e dytë që na ofron papa Francesco: “Ne jemi burra dhe gra që ecin drejt një premtimi, një takimi, drejt diçkaje, një toke, - na thotë Abrahami, - që duhet ta marrim në trashëgimi.

Mua më pëlqen që të shikoj, - na ka treguar në mirëbesim papa, - që Abrahami nuk ndërton një

shtëpi: nuk vendos një tendë, pasi e di që është në ecje dhe ka besim te Zoti, madje beson fort. Dhe ai, Zoti, do të na tregojë se cila do të jetë “toka”. Nga ana e tij, çfarë quan Abrahami një shtëpi? Atij i duhet një altar për të adhuruar Zotin, bën një sakrificën dhe pastaj e merr tendën dhe vazhdon që të eci dhe kjo është shtëpia e tij.

Pra, gjithnjë në lëvizje. Një sjellje që na kujton se një i krishterë i ndalur nuk është një i krishterë i vërtetë: ecja nis çdo mëngjes, ecja për t’iu dorëzuar Zotit, ecja për të pritur surprizat e Zotit, ndonjëherë jo të mira, ndonjëherë edhe të shëmtuara, mendja na shkon tek ndonjë sëmundje apo vdekje, por unë e di që Ti do të më dërgosh në një vend të sigurt, në një tokë që Ti ke bërë gati për mua. Ja pra, ka vazhduar papa: “Njeriu në ecje, njeriu që jeton në një tendë, një tendë shpirtërore; nga ana tjetër shpirti ynë, aty ku sistemohen shumë gjëra, instalohen shumë gjëra, e humb këtë dimension për të shkuar drejt premtimit, e në vend që të ecë drejt premtimit, ai e merr premtimin dhe e zotëron atë. Por kjo gjë nuk është diçka e mirë, nuk është e krishterë.

Një karakteristikë tjetër, një dimension tjetër i jetës së krishterë që e shohim këtu, në këtë farë të fillimit të familjes sonë, është bekimi – siç na ka shpjeguar papa Francesco. Për pesë herë na ka bërë të ditur që përmendet fjala “bekim”. I krishteri është një burrë, një grua që bekon, flet mirë për Zotin dhe për të tjerët dhe që bekohet nga Zoti dhe nga të tjerët.

Duke e përmbledhur, - siç thotë papa Francesco, - kjo është një skemë e jetës sonë të krishterë. “Zhveshja”, premtimi dhe bekimi, qoftë ai që na jep Zoti, qoftë ai që ne i japim të tjerëve. Të gjithë, edhe ju laikët, duhet të bekonin të tjerët, dhe t’i thoni fjalë të mira Zotit për të tjerët. Kjo është “të bekosh”. “Por ne jemi mësuar, - vuri në dukje papa



Francesco, -që të mos flasim gjithnjë mirë dhe se gjuha jonë shkon shumë nga e keqja, apo jo”?

Për këtë arsye ka shtuar “Më pëlqen urdhri që Zoti i jep babait tonë, Abraham, si një sintezë e jetës, siç duhet të jetë ai: “Ec në praninë time dhe ji i paqortueshëm”. Pra, ka shpjeguar “Ec në praninë time, pra ec përpara meje duke hequr dorë nga shumë gjëra, siç kam kërkuar dhe të mbash premtimet që unë të kam bërë, duke pasur besim tek unë dhe bëhu i paqortueshëm. Në fund, ka komentuar papa Francesco: “Jeta e krishterë është kaq e thjeshtë”.

Papa na ka sugjeruar që të mos e harrojmë stilin “zhveshjes”, premtimin për t’iu dorëzuar Zotit dhe tendën, pa u sistemuar dhe instaluar shumë; duke e mbyllur me bekimin që ua drejton të gjithëve.

Meditimi i mëngjesit që ka bërë papa Francesco, në kapelën:

“DOMUS SANCTAE MARTHAЕ”.

Këshilli i Konferencave Ipeshkvore të Evropës (CCEE)

PËR NJË MISTIKË VËLLAZËRIE PËRMES PËRSHPIRTËRISË

Takimi i 5^o i delegatëve kombëtar për marrëdhëniet me myslimanët në Evropë
Shkodër, Shqipëri, 7-9 shkurt 2018

Në Shqipëri, vend që deri para tridhjetë vitesh, me kushtetutë, deklarohet Shtet ateist, religjionet sot jetojnë një përvojë të mirë bashkekzistence që i jep shpresë dialogut ndërfaqet. Duke shkuar në Shkodër, me ftesë së Arqipeshkvit të vendit, Imzot Angelo Massafra OFM, në 25^o vjetorin e vizitës historike të Shën Gjon Palit të II-të (25 prill 1993), delegatët kombëtar për marrëdhëniet me myslimanët dëshmojnë interesin dhe punën kapilare të Kishës Katolike për dialogun me myslimanët në Evropë. Në këto tre ditë pune, delegatët e konferencave ipeshkvore janë ballafaquar rreth figurës së besimtarit mysliman dhe kanë diskutuar disa çështje baritore.



Kisha në Evropë është e angazhuar në dialog me bashkësitë e ndryshme myslimane në nivele të ndryshme (akademike, fetare dhe sociale, por edhe dogmatike, juridike dhe shpirtërore). Dialogu nuk është një aspiratë, por një përvojë e përditshme me gëzimet dhe sfidat e tija. Nga shkëmbimi i përvojave dhe i debateve aktive dhe shumë të gjalla, islami evropian paraqitet në shumës: një shumicë bashkësisë myslimane, ku dallimi, paraqet po aq sfida për të krishterët. Kështu rrugëtimi i realizuar deri më tani, që të mund të bëhet efikas sot, ka nevojë që të vihet në dëgjim edhe të përvojave fetare reciproke.

Në Shqipëri, pjesëmarrësit kanë njohur një realitet që jeton praninë e bashkësive fetare të ndryshme në një harmoni ndërtuese. Vuajtja mizore e përvojës së regjimit totalitarist, që ka imponuar një ateizëm shtetëror, ka sjellë afrimin e të gjithë besimtarëve, duke bërë që të piqet një ndjenjë e madhe tolerance dhe respekti mes besimtarëve të religjioneve të ndryshme. Shqipëria është një Vend që jeton mistikën e takimit. Është bash kjo karakteristikë tërësisht shqiptare që i ka nxitur delegatët kombëtar, të mbledhur në takimin e pestë, që të vendosin të thellojnë temën e *takimit mistik*, duke promovuar

“dialogun e përshpirtërisë”. Në Shkodër, pjesëmarrësit janë angazhuar që të përforcojnë kontaktet me bashkësitë myslimane edhe në nivel përshpirtërie. Në mbështetje të kësaj harmonie si dhe në angazhimin për nxitjen dhe promovimin e kësaj shenje dalluese bashkëjetese, përshëndeti edhe Kryetarja e Komitetit Shtetëror të Kulteve, znj. Loreta Aliko.

Një pjesë e punimeve i është kushtuar për të shënuar profilet themelore të besimtarit mysliman dhe mënyrat përmes të cilave [ai] jeton lidhjen e tij me Zotin. Tema është thelluar me kontributin e dy përfaqësuesve të bashkësisë myslimane të pranishme në Shqipëri: një imam sunit dhe lideri i bashkësisë Bektashiane të Vëndit. Pjesëmarrësit në debat nënvizuan rolin e lirisë, jo vetëm në nivel të zgjedhjes fetare, por edhe në nivel të mënyrave me të cilat besimtari ka ndër mend të jetojë lidhjen e tij me Zotin në brendësi të vetë familjes fetare: mënyra këto të gjitha të drejtuara kah liria e un-it për t'ia arritur bashkimin me Hyjin. Në traditën sufi kjo vjen përmes shoqërimit të një mësuesi shpirtëror. Besimtari është pjesë përbërëse e një rrugëtimi bashksior dhe kurrë individualistik. Ky rrugëtim i brendshme, që shkon deri në thellësinë e zemrës njerëzore, vend intim dhe i përveçshëm i dialogut me Zotin, i shpije të krishterët dhe myslimanët ta pranojnë veten si pjesë përbërëse e të njëjtës bashkësi të krijuar nga Hyji. Dhe bash aty, dialogu, në veçanti ai i jetës dhe i përshpirtërisë, mund të zhvillohet dhe të bëjë që të rriten marrëdhënie të vërteta miqësie dhe vëllazërie.

Më vonë, pjesëmarrësit, kanë thelluar tre pjesë baritore që përfshijnë marrëdhëniet me myslimanët: i pari, duke ardhur nga Austria, pa



paraqitjen e rrugëtimit të katekumenatit për t'i pranuar myslimanët që kanë kërkuar pagëzimin. I dyti që një thellim i përvojës shpirtërore duke u nisur nga ajo që ka jetuar **Imzot. Claude Rault**, Ipeshkëv emerit (në pension) i Laghouat Ghardaïa-së, në Algjeri. Imzot Rault ishte bashkëthemelues me at' Christian de Chergé (epror i murgjve trapistë të Tibhirine-s) i iniciativës *Ribat al Sala* (Lidhje paqeje) me të cilën një grup i vogël të krishterësh ka zhvilluar dialogun e përshtetërisë me miqtë myslimanë dhe bashkëvëllazërinë sufite të Medeas. Në fund është paraqitur përvoja franceze e shoqërimit të çifteve të përziera krishtero-myslimane që përbëjnë në vetvete një vend dialogu ndërjetar dhe që janë një sfidë baritore që duhet ndjekur. Në fakt, nevoja e një shoqërimi të personalizuar i këtyre familjeve – në veçanti sa i përket edukimit fetar të fëmijëve – dhe të një edukimi ndaj dashurisë përgjegjëse të çiftit, vijnë si nevoja urgjente. Në këtë detyrë, kisha dhe bashkësia myslimane janë të thirrura të dialogojnë me përgjegjshmëri për të mirën e këtyre familjeve.

Gjatë takimit është lexuar edhe mesazhi që **kardinali Jean-Louis Tuaran**, Prefekt i Këshillit Papnor për Dialogun Ndërfetar, u ka dërguar pjesëmarrësve dhe në të cilën i ka ftuar “të krishterët dhe myslimanët, që të promovojnë respektin reciprok, objektivitetin në të folur dhe në të shkruar mbi religjionin tjetër, dashtë-mirësinë, zemërdhembshurinë dhe mëshirën”. Që dialogu të ecë në një klimë paqësore dhe ndërtuese “nevojitet

– ka shkuar kardinali – një sforcim i ri nga të dy krahët për të shmangur 'fjalimin e urrejtjes' që është në zanafillë të dyshimeve reciproke, diskriminimeve, përjashtimeve, anashkalimit dhe pakënaqësisë”.

Në Shkodër, delegatët ndërkombëtar kanë vizituar Xhaminë e Madhe të qytetit, kuvendin e motrave Klarise, ish-kuvend françeskan i shndërruar në burg për të burgosurit e Shtetit gjatë regjimit totalitarist, dhe muzeun dioqezan që përmban dëshmi të ndryshme të 38 martirëve shqiptar.

Punët u mbyllën me një paraqitje rreth statutit teologjik të Islamit në reflektimin e krishterë bashkëkohor, temë që është dorëzuar nga Koncili i II-të i Vatikanit dhe që hap prospektiva të reja për t'i thelluar përvojat e dialogut të lindura dhe të jetuara në mbarë Evropën. Në ditën përmbyllëse, **Imzot Brendan Leahy D.D.**, Ipeshkëv i Limerick dhe përgjegjës i seksionit *Dialogu Ndërfetar i Komisionit Ungjillëzim dhe Kulturë* i CCEE-së, udhëhoqi Meshën Shenjte në Katedralen e Shkodrës dhe paraqiti disa reflektime në mbyllje të takimit.

Takimi u mbyll me vizitën në **Shenjtëroren e bektashinjve, në Krujë**, qendër përshtetërisë të njëjtën vëllazëri.

Gjatë ditëve të punimeve të takimit të 5^o të delegatëve nuk mungoj edhe prania ipeshkvij të Konferencës Ipeshkvnore Shqiptare, të klerit, rregulltarëve dhe rregulltarëve.

Dom Lush Gjergji
Prishtinë

CARLO CARRETTO
(1910 – 1988)

“Ndër ato ditë Jezusi shkoi në një mal për t'u lutur. Natën e kaloi duke iu lutur Hyjit“. (Lk 6, 12)

“Sot shumë njerëz ndihen të zbrazët në shpirt, sepse më nuk dinë të luten. Gjithsesi duhet ta zbulojmë uratën, sepse përndryshe me punën tonë të pandërprerë do të bëhemi skllav e jo bijtë e Hyji. - Carlo Carretto.

Carlo Carretto u lind dhe qe edukuar në një familje tradicionale katolike, me një fëmijëri dhe rini si shumë të tjerë, do të thosha të zakonshme dhe të “rregullt”. Mendoi dhe planifikoi jetën e tij në studime, në punë, në politikë, në arritje, në martesë, si gjithë njerëzit tjerë.

Mirëpo, përjetoj tri “kthime” apo tri thirrje hyjnore të cilat e kishin bërën më të ndryshëm nga të tjerët. Herën e parë kjo ndodhi kur ishte tetëmbëdhjetë vjeçar.

Thirrja e parë

Ja dëshmia e tij: “Më nuk isha i lumtur me traditën katolike. Si student fillova të lexoj literaturë mbi historinë. Së shpejti hetova se disa personalitete kishtarë, aty-këtu edhe ndonjë papë, nuk kishin ndonjë mënyrë të jetës në përputhshmëri me mësimet dhe udhëzimet ungjillore. Në dyshim shpreha hutinë time para familjes sime. Si përgjigje nëna ime më dha shuplakë, si vërejtje e cila atëherë përdorej në meset e fshatrave tradicional: ‘Kurrë nuk guxohet të flitet keq për meshtarë!’... U drejtova famullitarit, por edhe ai më mbajti leksion mbi shenjtërinë dhe pagabueshmërinë e Kishës... Ishin misionet në vendin tim. Shkova në kishë. Dëgjova predikimin, mirëpo kjo nuk kishte farë domethënie për mua, sepse isha krejtësisht indiferent... Mirëpo, kur u nisa për të shkuar në rrëfim të një meshtar i moshuar, më kujtohet kishte sy të çiltër dhe qetë, hetova se në shpirtin e tij është i pranishëm Zoti, që përmes tij kalonte Zoti...”

Ishte kjo “goditja” e parë apo prekje e hirit, i cili e zgjonte nga indiferenca dhe e nxiste që të merrej me çështjeve shpirtërore dhe fetare.

“Thirrja hyjnore është e fshehtë, sepse ndodhë kur je në errësirë e fesë. Ai zë është aq ledhatues dhe i butë, i qetë dhe paqësor, saqë duhesh të kesh heshije të thellë dhe të madhe në brendi për të pasur mundësi për ta dëgjuar. Dhe përsëri nuk ekziston

asgjë në tokë aq vendimtare, tërheqëse, asgjë aq e sigurt, aq e fortë... Thirrja e tillë është e vazhdueshme. Zoti gjithnjë thërret...”

Çfarë domethënie kishte për të kjo thirrje e parë? Çfarë kthimi ishte ky?

Ja dëshmia personale e Carlo Carretto-s: “Nuk do të thosha se në 18 vitet e para të jetës sime nuk ka qenë i pranishëm Zoti. Familja ime ishte vërtet katolike. Në disa momente më pak e përjetojmë Zotin, e në disa momente tjera Atë e përjetojmë më thellë dhe më fortë. Të jesh i vetëdijshëm për këtë – ja kjo është risia! Kur është fjala për Zotin, kjo atëherë është shenjë e kthimit. Gjithnjë e më shumë



kam hetuar se ajo risi nuk varet më nga unë, nga ne. Zoti na paraprinë dhe na jep hir që të jemi të vetëdijshëm për praninë e tij në jetën tonë. Ja shembulli i nënës dhe fëmijës. Fëmija para lindjes është në kraharonin e nënës. Medicina na mëson se edhe gjatë nëntë muajve në kraharonin e nënës së tij, në një mënyrë e njeh nënën e tij, e di se a e pranon ajo apo jo... Kjo është njohuria fiziologjike. Ja, kthimi është moment i cili na jep “risi” mbi njohurinë e Zotit. Ndiejmë se ecim me më tepër vetëdije në prezencën e Tij...”

Në këtë vetëdije të re apo kthim, siç thotë Carlo

Carretto, ai jetoi i lumtur, studioi, ishte plotë jetë dhe entuziazëm. Por mendoi edhe në martesë, në rregullimin e jetës, siç thuhet sot. Punoi në kuadër të Aksionit Katolik, ishte i mrekullueshëm në fjalë, human në mendime, i përzemërt, ngrohtë dhe i dashur në trajtime. Tërhoqi të gjithë, me një fjalë ishte njeri i cili u jepte besim të plotë.

Thirrja e dytë

Dhe ja edhe “goditja” e dytë e hirit, kthimit. *“Isha 23 vjeçar dhe mendoja të martohem, as që kam menduar se për mua ekziston ndonjë rrugë tjetër jetësore. Atëherë takova një mjek i cili më foli rreth Kishës dhe mbi bukurinë e shërbimit të plotë në të, mirëpo duke qëndruar në botë. Nuk e di se çka ndodhi ato ditë me mua, mirëpo është fakt, deri sa lutesha në kishën e zbraztë... dëgjova zërin të cilin e pata dëgjuar edhe gjatë rrëfimit tim para misionarit plak: 'Ti nuk do të martohesh. Ti do t'ma flijosh jetën tënde. Unë do të jem dashuria e jote përgjithmonë!' Dhe në mua ndryshoi gjithçka. Befasisht Zoti pati aso force në mua, sa që mu duke e çuditshme apo e pamundur edhe vet mendimi se do të mund të dashurohem në ndonjë vajzë...”*

Carlo Carretto punoi natë e ditë, sikur do të duhet dhe mund të ndryshonte gjithçka, ta kthente tërë botën. Ishte i zgjedhur për kryetar të Aksionit Katolik. Edhe në jetën politike kishte mjaft suksese. Mirëpo, pikërisht puna, angazhimi i qëndrueshëm në politikë, në Aksionin Katolik, suksesi, shkaktuan në të zbrazëti, idhtësi, zemërim, lodhje, ngopje. Më nuk ishte i lumtur, i qetë dhe i gëzuar. I dukej se do të dëshironte Jezusi t'ia shtronte pyetjen e trefishtë, si Pjetrit: *“Simon, biri i Gjonit, a më donë më tepër se këta?”* (Gjn 21, 15).

Carlo Corretto më nuk ishte i ri. Tanimë ishte 44 vjeçar, të cilat konsideronte se i ka “investuar” dhe përjetuar mirë dhe intenzivisht, të projektuara dhe frymëzuara. Mendonte në vetvete: *“Çka kisha mundur dhe dashur ende të bëjë më tepër e më mirë?!”*

Thirrja e tretë kontemplacioni në shkretëtirë

“Zoti gjen mënyra të jetë i pranishëm, të na nxisë e sfidojë. Më ftoi nga zbrazëtia, të cilën ndjehesha në vete. Isha i magjepsur me punën në Aksionin Katolik... E kuptova se më nuk isha në gjendje të ktheja dikë, më nuk isha i suksesshëm. Ndiheja i varfëruar. I thashë vetvetës: 'Je i vdekur, gati je në përfundim!'. Gjithnjë e më shumë hetoja në vete zërin e Jezusit: 'Je shërbëtor i padobishëm. Pa mua

nuk mund të bëni asgjë'. Nuk e dija se çka është kundrimi ose seditja shpirtërore. Nuk dija kah dhe kujt t'i drejtohem. Mirëpo, Zoti më dërgoi në vendin ku kisha kohë për të medituar, lutur, për thellimin e besëlidhjes me Zotin... Ishte kjo thirrja më e fortë në jetën time, dhe unë menjëherë i përgjigja zërit i cili më thërriste: “Eja tek unë në shkretëtirë!... Nuk dëshiroj më veprën tënde, uratën tënde, por ty dhe dashurinë tënde’.”

Gjurmëve të Charles de Foucauld-it shkoi edhe ai në shkretëtirën e Saharës. Dhe pikërisht atje takon hire të shumta, gjithnjë e më shumë, gjallërisht dhe thellësisht e përjetonte praninë e Hyjit, pasurinë e jetës së kundrimit dhe seditjes. Fiton përvojën e fesë, dhe me gëzimin e zemrës vërteton përmbytjen e madhe të jetës shpirtërore dhe fetare: Hyji kërkon shumë, por jep gjithçka!

Qysh në thirrjen e parë, ndryshoi jetën e tij. Zoti e tërhoqi dhe përfitoi tërësisht. Në thirrjen e dytë Zoti e “liroi” nga detyrimet familjare. Carlo Carretto e mendoi se jeta e krishterë ishte në angazhimin e përditshme të krishterë, në punë, në politikë, në shumë ligjërata dhe takime të Aksionit Katolik, në shkrime dhe të folurit për Hyjin. Ishte kjo joshje, tundim i “aktivizimit”, punës pa mision apo dërgim të vërtetë, që do të thotë pa Zotin. Të punohet për të punuar, vetëm ashtu, vërtet është vdekje për fe, për dashuri, siç na tregon dhe dëshmon Carlo Carretto dhe shumë të tjerë. Dhe pikërisht për këtë shkak përjeton edhe thirrjen e tretë, që së fundi të kuptonte dhe pranonte këtë: është me rëndësi të jetosh, besosh, dashurosh, dëshmosh, të jetosh përvojën e fesë, e jo vetëm të punosh, të bësh diçka, të kërkosht të tjerët.

Para thirrjes së tretë në jetën e Carlo Carrettos qenë stërmblendur zbrazëtia, pakuptimshmëria, veprime pa kundrim, pa meditim, uratë, gjë kjo që do të thotë vetëvrasje shpirtërore, rrënim dhe vdekje e ngadalshme.

Rabindranath Tagore duke folur mbi përvojën dhe jetën pa Zotin, thotë: *“Kush është tepër i shqetësuar për të bërë mirë, shpeshherë mbaron ashtu që të mos jetë i mirë.”*

Thirrja e Carrettos drejtuar rinisë

Nga përvoja personale e shkretëtirës, që do të thotë, shoqërimi me Hyjin, Carretto ia tërheq vërejtjen rinisë së sotme: *“Sot të gjithë të rinjtë flasin mbi atë se si duhet ndihmuar të varfërve, të merren me refugjatë. Në të vërtetë të krishterët nuk mbyllin sytë përpara realitetit politik dhe sindikal*

me probleme të shumta shoqërore... Janë të shumtë ata cilët për çdo mbrëmje flasin mbi të varfëritë, mirëpo kurrë nuk kanë bërë asgjë konkrete për ta. Të tjerët do të dëshironin të gjenin zgjidhjen e këtyre problemeve në mënyrën perëndimore: kam mjaft e për këtë edhe të jap. Do ta kërkoj veshmbathjen e vjetër... Nuk duhet harruar se Jezusi ka paralajmëruar mundësinë e tretë: erdha që të vuaj me ty... Të jetësh me ta dhe të ndash jetën për ata – me fatin e tyre – është shumë e rëndësishme... Në të vërtetë kjo është dashuria.”

Ja disa pyetje themelore nga jeta dhe përvoja e fesë të cilat iu shtronte rinisë Carlo Carretto: “A je i gatshëm edhe ti të mohosh ndonjë send për të qenë në botën e sotme dëshmitar i Hyjit? Dije këtë: pasuria, kariera, popullariteti në botë, egoizmi, interesi, seksi...të bëjnë skllav, premtajn shumë, por nuk japin asgjë. I mirë është ai përtej këtyre gjërave dhe realiteti, ky është Zoti”, dëshmonte Carlo Carretto. Dhe vazhdonte: “Zhurma është heshtja e rinisë moderne... Heshtja është pasuria e përsosur e njeriut të edukuar shpirtërisht... Sot shumëkush ndihet i ngopur dhe lodhur nga jeta, sepse nuk kanë më hapësirë për uratë...”

Carlo Carretto, jetoj disa vite në shkretëtirën e Saharës, ku arriti përvojë të thellë të fesë, të uratës, të soditjes. Këto përvoja pjesërisht janë të botuara në librin *Letrat nga shkretëtira* (1965), më vonë edhe në vepra tjera si *Dashuria është e rëndësishme* (1968), *Përtej gjërave* (1970), *Hyji i cili vjen* (1972) dhe *Ati im, Ty të dorëzohem* (1975).

Në Shpello - Umbrijë afër Shën Franit

Duke ndjekur përshpirtërinë e Charles de Foucauld-es, Carretto tërhiqet në vetmi, dhe gati si vetmitar, në Shpello (Umbrijë), afër Assisit, thellon jetën e tij kontemplative, krejt afër Shën Franit. Aty me vite, vërtet deri në vdekje (1988), ishte pika orientuese për shumë të rinjë, të cilët kërkonin vetveten, Zotin, kuptimin e jetës dhe veprimtarisë, në shumë mjedise, biseda, uratë.

Kështu Shpello u bë “Taize-a” italiane, me këtë duke ofruar kontribut të vlefshëm dhe të drejtë përshpirtërisë së kohës sonë.

Vetë Carlo Carretto shpjegonte dukurinë e Shpello-s me këto fjalë: “Shpello është vend lutjeje. Kush vie këtu në mëngjes, punon katër orë, kurse lutet katër orë tjera pasdite. Nuk lejoj as studime, sepse këtë mund ta bëjnë edhe në vende tjera, kudo. Puna dhe urata... Sot të gjithë ndiejnë njëfarë lakmie, sepse nuk japin mjaft kohë, hapësira – zemër për uratë. Neve duhet të gjejmë hapësira për lutje, përndryshe me punët tona të shumta, ne do të

shndërrohemi në skllav, punëtorë e jo në bijtë e Hyjit.”

Ai pikërisht kishte marrëdhënie privilegjuese me të rinjtë, ishte mik, vëlla, i përzemërt dhe i hapur në çdo kohë dhe në çdo vend. Nga kjo përvojë me ta ka arritur deri te ky përfundim: “Të rinjtë janë pozitiv, më pak janë të lidhur pas parave, janë më të ndjeshëm ndaj problemeve të njerëzve. Njeriu i cili nuk ka fe, është i mbyllur në shpellën e tij, nuk komunikon dhe kështu shkatërrohet. Të kesh fe do të thotë të mos jesh askurrë i vetmuar. Duke besuar në Zotin ngadalë ngjallet shpresë dhe më pas e gjitha shndërrohet në dashuri.”

Në jetën dhe veprën e Carlo Carrettos, ceken disa vlera themelore të cilat duhet marrë parasysh shumë seriozisht. Në rend të parë mashtrimi apo iluzioni i verbimit pa soditje apo dërgim, pa Zotin dhe pa të afërmin, e cila krijon vetëm zbrazëti, pakënaqësi, lodhje... Carretto pati guximin dhe fuqinë që të shqyrtonte jetën më thellë, të ndahet nga jeta e përditshme, të fillonte rishtas nëpërmjet tri rrugëve – tri thirrjeve – që para së gjithave t’ia fillonte nga vetvetja, me Zotin, me ndihmën e tij edhe me të tjerët dhe për të tjerët.

“Për mua urata u bë puna më e madhe, interesi im më i rëndësishëm, dhe qysh tani kam kuptuar se çka në të vërtetë do të thotë të përfshija të tjerët në lutjen time... Për këtë lutja e vërtetë kërkon prej nesh më tepër “pasivitet” se aktivitete, më tepër heshtje se sa fjalë, më tepër adhurim se sa mësim, më tepër gatishmëri shpirti se sa aktivitete, lëvizje, pra, më tepër fe se sa arsye.”

Carlo Carretto tri herë pranoi sfidën hyjnore, atë të kohës sonë, që mund – dëshiron-duhet harmonizuar vetveten me Zotin, me botën e sotme. Ky provim është i pashmangshëm për çdo njeri. Trashëgimia shpirtërore e Carlo Carrettos është jashtëzakonisht e vlefshme si përvojë jete dhe feje, si qasje metodologjike ndaj jetës dhe punës me fe dhe përmes fesë, me fuqinë dhe frymëzimin e Shpirtit Shenjt – Dashurisë.

“Shkretëtira” – Zoti – është në ne, me të vërtetë kjo është të duash, të aktivizohesh, të jetosh brendinë, thellësinë e qenies dhe ndërgjegjes, sepse këtu, në ne, gjendet dhe është Zoti.

“Edhe pse ende nuk kisha lexuar Rregulloren e Vëllezërve të Vegjël të Jezusit, unë hyra në bashkësinë e tyre; ende pa e njohur Charles de Foucauld-in, fillova rrugën e tij... Duke ecur me Vëllezërit e Vegjël rrugëve të shkretëtirës, kam zbuluar mirësinë e kësaj rruge jetësore; duke ndjekur atin De Foucauld-in jam bindur se ajo rrugë e tij është edhe rruga ime” thoshte Carlo Carretto.

Dom Nosh Gjola
Podgoricë

PUSHIMI DHE UDHTIMI I PROGRAMUAR (Pjesa e fundit)

4. Rivaliteti në mes çiftit martesor

Gjatë periudhës së adaptimit apo përshtatjes, çifti martesor fillon ta jetojnë jetën normale, fillojnë raportet normale dhe komunikimi i natyrshëm. Këtë mund ta përshkruajmë me fjalën “model” ose “tip” që krijon çifti i ri gjatë jetës së përbashkët.

Një prej modeleve është edhe ai i “rivalitetit”, që

thjeshtëzojmë ashtu që nuk mund të pranohet. Për shembull, njëri prej çifti bënë pyetje: “Si do ta kalosh pushimin e dielës?” dhe ai tjetri, i përgjigjet: “Se nuk është nevoja të pyetsh dy ditë përpara, sepse të gjithë e dinë, se në pranverë është koha e ndryshueshme dhe nuk mund të flitet deri në orët e mëngjesit të dielës!” Po që se tjetri e pyet partnerin:



nuk është asgjë tjetër përveçse njëri prej partnerëve dëshiron të jetë mbi tjetrin. Kjo shprehet te programimi, te veprimtaria e llojllojshme e jetës së përditshme ose përcaktimit të kohës së pushimit, ku dhe kur. Po ashtu vërehen edhe sjelljet neurotike, edhe ato qëllimisht ku njëri ia tërheq vëmendjen tjetrit, se diçka nuk është në rregull. Çifti rival është gjithëherë i gatshëm që të hedhin çfarëdo dyshimit vetëm për vete që gjërat të jenë në rregull, kështu shoh vetëm parregullsi të tjetrit, mundohet ta blejë veshmbathjen me çmim të ultë, për ta fajësuar tjetrin që nuk di të kursejë. Gjithashtu di të jetë në vëmendje që ai nuk bënë ndonjë shpenzim të panevojshëm përderisa ai tjetri vetëm shpenzon aty ku nuk duhet.

Gara e rivalitetit vërehet edhe gjatë bisedimeve. Një prej teknikave të folmes është atëherë kur e

“çka dëshiron të përgatisësh për drekë?” ai i përgjigjet: “a thua se duhet për çdo di të pyetsh dy herë dhe viti ka 365 ditë dhe ende nuk e di se cili ushqim të pëlqen!” Po se njëri thotë: “propozimi i partisë së majtës mbi reformat e shkollës janë pothuajse të barabartë me atë të partisë së djathtë!” ai tjetri do t’i përgjigjet: “barazia duket vetëm nga shikimi i parë, sepse pasojat janë krejt tjera edhe ashtu bile edhe përjashton njëra tjetrën, ashtu nuk është e mundshëm t’i krahasosh mes vetes programin e partisë së majtës me atë të djathtës!”

Sjelljet e përshkruara janë të ngjashme me sjelljet në mes çifti martesor, i cili zhytet dita-ditës në vorbullën e ideologjisë ose në sferat e psikologjisë. Zakonisht në polemikat e tilla që zhvillohet në mes partnereve nuk mundet asnjëra palë ta humbin luftën apo betejën, sepse gjithëherë ia

imponojmë tjetrit lojën e re të logjikës. Për shembull, gjatë dialogut apo bisedës, se si e kalon pushimin e dielës, njëri thotë: “E diela është një ditë e mrekullueshme, që tërë familja largohet nga shtëpia dhe del në natyrë...” që nuk është asgjë tjetër përveç një përshkrim, përderisa ai tjetri e vazhdon: “Ndoshta nuk mendon, se gjatë dielës është e domosdoshme të dilet në natyrë!” Që nuk është asgjë tjetër përveç norma apo normativi. Prapë ai tjetri i thotë: “A ke dëgjuar se ka vdekur Palok Curri!” Që nuk është asgjë tjetër përveç situata konkrete, përderisa ai tjetri i përgjigjet: “Herët a po vonë të gjithë duhet të vdesim!” Që nuk është asgjë tjetër përveç një konstatim i përgjithshëm. Atëherë tjetri vazhdon: “E Drejta njerëzore për të cilat merret lëvizja feministë janë mjaft bindëse!” Është vetëm një qëndrim ideologjik, përderisa tjetri i përgjigjet: “Nuk di, se si ka përfunduar martesë e Pikacos? Feministët nuk janë të kënaqura me asgjë!” Kjo është sfera psikologjike e te shprehurit. Kështu mund të numërojmë shembujt të tjerë që e paraqesin mënyrën e rivalitetit që kalon nga një sferë në tjetrën dhe askurrë nuk ka fund. Mjafton të ndalemi pak dhe të mendojmë, dhe do të gjejmë shumë gjëra. Në fakti është i rëndësishëm në këtë situatë apo në raportet e këtylla të kesh veshin për ta dëgjuar atë tjetrin dhe biseda nuk vazhdon atje ku ai tjetri e ka përfunduar. Sepse çifti që jeton në rivalitet dëshiron gjithherë ta përjashtojnë nga loja partnerin dhe ashtu për t'i shprehur aftësitë e veta. Kuptohet në rivalitetet e tilla është e pamundur të krijohen programet e përbashkëta, jo vetë ato të pushimeve apo daljeve në natyrë apo në udhëtime, por as jetës së përbashkët që kërkon minimumin ekzistencial.

5. Aftësia për të biseduar

Njeriu e arrin pjekurin vetëm atëherë, kur e merr mbi vete krejtësisht përgjegjësin dhe pasojat e vendimit. Personi është i zhvilluar ose i pjekur kur arrin moshën e pjekurisë, që është i aftë për të vendosur e për të zgjedhur vendimin, problemin, për t'u përcaktuar në këtë apo në tjetrën mënyrë, ka mundësi për të vlerësuar gjërat e për të përcaktuar njërin prej tyre. Po ashtu është individ, i cili e pranon veten në tërësi ashtu siç është, gjithashtu e pranon edhe tjetrin qoftë partnerin e jetës, qoftë edhe mjedisin apo rrethin në të cilin jeton ashtu siç janë. Vendimin dhe zgjedhjen e merr si të vetat duke pranuar edhe pasojat që rrjedhin nga një vendim i tillë.

Do t'i numërojmë disa modele të sjelljeve që janë tipike për njeriun e pjekur apo individin, të cilin e vendosim në situatë, që ka të bëjë me botën në të cilin jeton. I cili di ta vlerësoi sjelljen e mjedisit duke përdorur arsyen e mendjes së shëndoshë edhe

njëherë se çka ai pret prej tjerëve:

a) Tipi i tillë gjithherë është i sinqertë pa maskë, ashtu siç është paraqitet të tjerëve, pa dorëza.

b) Vepron gjithherë në harmoni me ndjenjat e brendshme. Gjithherë i përpiktë dhe di mirë se çka do, sepse e ka të definuar mirë jetën, pikëpamjet apo mendësinë, e ka identitetin kombëtar, gjinor, kulturor, etiko-fetar dhe moral, politik dhe filozofik.

c) Tipi i tillë është gjithherë i aftë për ta kuptuar mjedisin që e rrethon apo gjërat që gjinden jashtë tij, ashtu siç janë të cilat dallohen dukshëm nga bota e tij. Po ashtu dallon mirë gjërat prej gjërave.

d) Ai gjithherë dhe kurdoherë i pranon dallimet që i ndajnë partnerin si mundësi, në të cilën mund diçka edhe prej tjetrit, të mësoi. Refuzimin e idesë së vet nga tjetri nuk e merr si shenjë moskuptimit, por si shenjë e pikëpamjeve të ndryshme.

Ja një shembull që e paraqet pikëpamjet apo këndvështrimet e ndryshme: Dy trumcakë rrinin të kënaqur duke u freskuar pak në të njëjtën pemë, që ishte një shelg.

Njëri rrinte në maje të pemës e tjetri poshtë në bigëzim të degëve.

Pas pak kohe trumcaku që qëndronte lart në maje të pemës, për ta thyer akullin pasi kishte pushuar tha: “O, sa të bukura që janë këto gjethë të gjelbra!”

Trumcakut që rrinte poshtë këto fjalë iu dukën ngacim, prandaj edhe ju përgjigj në mënyrë të prerë: “A mos je i verbër? A nuk e sheh se janë të bardha?”

Ndërsa ai që rrinte lart i tha i zemëruar: “I verbër je ti, sepse gjethet janë të gjelbra”. “Vë bast puplat e bishtit se janë të bardha. Ti nuk kupton asgjë. Ti je i marrë” - ndërhyri trumcaku që rrinte poshtë me sqep të ngritur lart.

Trumcakut që rrinte në maje të pemës filloi t'i vlonte gjaku dhe pa menduar dy herë u lëshua fluturim mbi kundërshtarin e tij për t'i dhënë një mësim të mirë. Trumcaku tjetër nuk lëvizti. Kur ishin afër, njëri përballë tjetrit, me puplat e qafës të shpupurishura prej zemërimit para se t'ia fillonin dyluftimit ndodhi që të shikonin në të njëjtin drejtim, të shikonin lartë.

Trumcaku që vinte prej së larti e lëshoi një: “Oh” që shprehte mrekulli: “Shiko, shiko, po këto qenkan të bardha.

Atëherë i tha mikut të tij: “Provo dhe eja me mua atje lart, ku isha unë më parë.”

Fluturuan mbi degën më të lartë të shelgut e këtë herë thanë që të dy së bashku: “Shiko, shiko po këto qenkan të gjelbra”.

Ose tjetri shembull, dy veta rrinë para numrit 6 që është i shtrirë për tokë horizontalisht, njëri e sheh gjashtë (6) dhe tjetri e sheh nëntën (9), varet nga cili kënd shikohet.



e) Në mënyrë të arsyeshme, ai ballafaqohet me personin tjetër dhe në kontekstin i pranon ashtu siç janë me gjitha dhuntitë apo shprehitë që i posedon, qofshin të mira qofshin edhe mungesat, por jo në pamjen ideale (ashtu siç dëshiron të jetë) dhe jo sipas pamjes (si e ka paramenduar ai) sepse ai apo ajo e kupton se nuk ka ditë pa natë as natë pa ditë, përsosmëria nuk ekziston në këtë planetin tonë, por mjeshtri ja e jetës është të balancohen si pjesa e errët me atë pjesën e dritës.

f) E pranon përgjegjësin për gjitha gjërat, qofshin ato që i ka dëgjuar, i ka ndje dhe i ka parë. Ai kurrë nuk i mohon ose nuk ia përshkruan tjetrit gjërat të cilat i ka parë, i ka bërë apo i ka ndje. Por ai i merr mbi vete përgjegjësin e plotë pa arsyetim apo pa ia hedhë fajin tjetrit.

g) Tipi i pjekur, i ka të përpunuar mirë principet dhe tekniken e raporteve me tjerët. Ai gjithherë përgatitet për bisedë apo dialog, po ashtu për të qenë biseda e frytshme, ai i verifikon të gjitha faktet e mundshme. Madje analizon pohimet apo mohimet se si ato shprehen, zërin, mimikën e të gjitha shenjat tjera të folmes së njeriut.

Ndërsa tipi i njeriut të papjekur nuk i mbush këto kritere, por ato sillen sipas momentit, emocioneve, thashethemeve, sepse janë të paafte për të verifikuar faktet, për t'i frenuar emocionet e për ta përdorur arsyen e mendjes së shëndoshë. Ai nuk

është as i aftë për ta kuptuar jo vetëm tjetrin, por as vetveten në mënyrë të drejtë, dhe objektive apo reale. Ai jo vetëm nuk i verifikon faktet e llojllojshme, por as nuk di t'i shpjegojë arsyen apo qëllimin e tyre. Të gjitha gjerat që arrin nga bota e jashtme i vëzhgon nga prizma e ngarkesave, thashethemeve, qofshin ato psikike qofshin ato fizike, qofshin nga aspekti i paragjykimeve. Thujtse është vëlosur në bindjen e tij, se ai ka të drejtë dhe të gjithë të tjerët jetojnë në mashtrimin e jetës. Zakonisht tipat e tillë janë kokëfortë, të ashpër, fanatik i çfarëdo bindjes, tiran, nuk pranojnë kompromis, mendojnë qe vetëm ideja e tyre është e vërtetë dhe e vetme që duhet të respektohet nga ai tjetri etj. Zakonisht tipat e tilla janë të paqartë, të pakuptueshëm, të papërshtatshëm si edhe të pamëshirshëm – sadist etj.

Çdo njëri mundet lehtë ta konstatojnë gjendjen e vet të pjekurisë. Por duhet të ketë kujdes që mos të absolutizohen pohimet më lartë se shumë lehtë bie në vorbullën e vetëmashtrimit. Sepse njerëzit dinë në mënyrë perfide për t'u paraqitur si njerëz të ngritur, të pjekur, të aftë për të dëgjuar etj. etj. Por duhet të jesh psikolog i mirë që ta kesh syrin e shqiponjës ose depërtues, si për shembull, nga vetë shprehja apo artikulimi i fjalëve, me shprehjen e mendimit që nuk posedon logjike e nuk ndërliiden me situatën konkrete. Në këtë rast mund ta kemi njeriun me

mendësinë e fëmijës, por mashtrues i mirë dhe gjysmak apo i çoroditur. Të rriturit zakonisht ia shatojnë fëmijëve të vet programin apo modelin, qoftë i pjekurisë apo qoftë i papjekurisë që do të mblesin fëmijë, gjysmak apo të çoroditur për tërë jetën. Shumë varet zhvillimi normal nga ana e prindit për t'ia arrit pjekurin jo vetëm fizike por edhe psikike e afektive ose emocionale.

Po qe se prindërit gjinden në ndonjë situatë të “vegjetimit”, dhe si të tillë ende nuk e kanë tejkaluar konfliktin, ngarkesat, paragjykimet as nuk i kanë harmonizuar jetën në mes vetes (në mes partnerëve). Partnerët e tillë zakonisht janë edhe të paqartë ose konfuz edhe përpara fëmijëve të vet, atëherë edhe fëmija e tyre do t'i marrin shprehjet apo vetit e prindit, që nuk kontribuojnë për pjekjen e njeriut por fatkeqësisht atë jo vetëm se e hutojnë por mbetet fëmijë i pa zhvilluar edhe pse fizikisht është i rritur apo i moshuar!

6. Mbi gjitha gjërat nuk mund të akordohen

Po qe se për një partner është dashuria diçka e tmerrshme, atëherë nuk është asgjë tjetër përveç papjekuria e mos të themi njeriu i llastuar, i cili ende nuk ia ka arritë identitetit të plotë e kurrë nuk e ka përjetuar dashurinë, por fatkeqësisht ka mbetur në sferën e kafshës apo të impulsit seksual, i cili e asgjëson jo vetëm veten, por kjo bindje do ta ndjekin deri në vdekje. Po qe se tipi i tillë edhe martohet, atëherë partneri tjetër e përjeton apo fiton një përshtypje se në shtëpinë e tij ose të saj ka ardhur një tjetër zot shtëpie, i cili kërkon në mënyrë urdhëruese dhe tjetër rregull, sipas shijes së tij ose të saj.

Atë çka e frikëson partnerin, është ai tjetri, në të cilin dashurohet dhe me të cilin apo të cilën dëshiron edhe të martohet, por nuk e njohim brendinë e tij, pikëpamjet ashtu pas martesë ai i dashuri ose e dashura si do të sillet? nuk e dimë, a do të jetë i butë, i mirë apo tiran, por mirë e di se jam, ai ose ajo me të cilin do të ndajmë fatin e jetës, për këtë të paguhet që të orvatesh, të flijohesh për ta fituar dashurinë e tij. Sepse dashuria është dhuratë që dhurohet vetvetiu. Por tjetrin duhet ta marrë ashtu siç është, të njëjtën gjë vlen edhe ta pranosh edhe veten ashtu siç je në realitet. Çdo gjë në mes partnerëve nuk mund të bihet në ujdi, të akordohemi, sepse është e pamundur, se njeriu nuk është objekt por subjekt, me gjitha tiparet e mira dhe ato të këqija, për këtë nuk bënë të jetohet në iluzion.

Nganjëherë çiftin martesor e rrëmben iluzioni, duke jetuar në botën e ëndrrave, imagjinatave derisa nuk vetëdijësohet e zbret në tokën reale, e cila bart me vete edhe sëmundjen, dobësitë, shfrenit, të cilat janë po ashtu edhe në bashkë partnerin tonë. Njeriu si i tillë sigurisht duhet gjithëherë të jetojë në shpresë,

se gjithëherë ka shpëtim po qe se duam të shërohemi, po ashtu gatishmëria për t'u shëruar, për t'u korrigjuar, për t'i avancuar virtytet apo vetit e mira, duke pranuar nga partneri të gjitha ato veti që të pëlqejnë apo nuk të pëlqejnë. Fjala apo biseda është mjet komunikimit, që kërkon ushtrime apo stërvitje, për mos të mbetet sterile, e zbrazët, pa domethënie ose jehonë e vetvetes, por fjala është si uji që e ndihmon sythin e dashurisë të shpërthejë nga kopshti i dashurisë, për të cilin duhet të kujdesen ditë e natë. Sepse në veprim është virusi, i cili kërkon nga qeliza që të krijojnë viruset e reja, të ngjashme me të parin, ashtu pika e parë pikon në dashuri, që mund ta përfshij trupin, e cila do të hapet si kanceri, por menjëherë mund të bëhet e pandjeshme për çfarëdo helmit.

Po qe se dëshirojmë ta analizojmë dashurinë, përmes bisedës apo dialogut, atëherë duhet vetit apo mungesat ose të gjitha gjërat negative të korrigjohen, që kërkon jo vetëm durim por edhe orvatje të përbashkët me vullnetin e çeliktë. Në anën tjetër vetëdijesimi se nuk ka tip ideal, sepse virusi i së keqes është i mishëruar në njeriun konkret. Mund ta kemi të kaluarën, e cila është në duart e mia, por unë jetoj të tashme, që e kaluara mund të bëhet vetëm mësuese dhe jo mit, për ta krijuar të ardhmen. Njeriu normal dhe i shëndosh dëshiron jo vetëm ta realizojë apo ta aktualizojë veten por edhe të jetë fatlum, për t'ia arrit këtij qëllimi, atëherë ndërhyjnë dashuria, e cila i tejkalon pengesat, ndryshimet, moskuptimet, pikërisht plotësohemi me personin tjetër në ato pika dalluese, që nuk është asgjë tjetër përveç një mozaik i bukur i jetës së përbashkët në gjirin martesor.

Sapo kemi arritur deri te përshkrimi i frikës që krijohet në individin e çiftit martesor. Ndoshta të duket se kemi tejkaluar në pikëpamjet morale, për të cilat nuk kemi dyshuar, por zbulimi, që e kemi zbuluar në brendinë e vetes, se jemi person, i cili mund të dashurohet dhe të jetë i dashuruar nga tjetri. Ai dëshiron po ashtu t'ia japin dashurisë kafen pozitive e mos të mbetet i zbrazët. Një ndjenjë e tillë nuk është asgjë tjetër, përveç emocioni i individit.

Kush mendon se dashuria lindë, apo blihet, ai duhet të llogarisin, se kurrë nuk do ta përjetojë atë. Mund t'ia dëshirojmë njëri - tjetrit gjërat më të mira, mund të flijohemi, të mundohemi ta kuptojmë tjetrin ose t'i ndihmojmë, por pa përvojat e “ramjes së lirë” të natyrshmërisë apo spontanitetit nuk do të përjetosh zjarrin apo ngrohtësinë e saj - të dashurisë, e cila zbulohet, zhvillohet, fisnikërohet, kultivohet, orvatet, zhvillohet dhe në fund bëhet frytdhënëse, që e krijon kopshtin fatlum ku mbretëron gjuha e zemrës që ja jep njeriut qëllimin e jetës por edhe bashkësisë martesore kuptimin.

“PORTALËT QË MË QUAJNË HERETIK? I NJOH ATA QË SHKRUAJNË, NUK I LEXOJ”

*Françesku jezuitëve në Kili e Peru : jo fetarëve që jetojnë si beqarë llafazanë
(Intervistë e Atë Antonio Spadaro me Papën Françesku në Kili më 16 janar dhe në Peru më 19 janar)*



Atë i Shenjtë, cilët kanë qenë gëzimet e mëdha dhe keqardhjet e mëdha që keni patur në papninë tuaj ?

“Periudha e papnisë është mjaft e qetë. Nga çasti në të cilin në Konklav kuptova se çfarë po ndodhte – një befasi e çastit për mua - , kam ndjerë shumë paqe. Deri më sot ajo paqe nuk më është ndarë. Është një dhuratë e Zotit, për të cilën i jam mirënjohës. E me të vërtetë shpresoj se nuk do të m'a heqë. Gjërat që nuk më heqin paqen por më shkaktajnë dhimbje janë thashethemet. Për thashethemet më vjen keq, më trishtojnë. Ndodh shpesh në botët e mbyllura. Kur ndodhin në një rreth priftërinjsh apo fetarësh më vjen pyetja : po si është e mundur? Ti që ke lënë gjithshka, ke vendosur të mos kesh pranë një grua, nuk je martuar, nuk ke fëmijë.... don të mbarosh si një beqar i vjetër llafazan? Oh, Zoti im, çfarë jete e trishtuar!”.

Çfarë qëndresash keni hasur e si i keni jetuar?

Përpara vështirësive nuk them kurrë se është një “qëndresë”, sepse do të thonte se hiqnja dorë nga

dallimi, gjë të cilën nuk dua t'a bëj. Është e lehtë të thuhet se ka qëndresë dhe mos të kuptosh që n'atë kundërshti mund të jetë edhe ndonjë thërrime së vërtete. Kjo më ndihmon edhe të relativizoj shumë gjëra që, në pamje të parë, duken qëndresa, por që në të vërtetë janë kundërveprime që lindin nga ndonjë keqkuptim.... Ndërsa kur e kuptoj që është një qëndresë e vërtetë, sigurisht, më vjen keq. Disa më thonë se është e zakonshme që të ketë qëndresa kur ndonjëri don të bëjë ndryshime. E famshmja “është bërë gjithmonë kështu” mbretëron gjithandej dhe është një tundim i madh të cilin e kemi provuar të gjithë. Qëndresat mbas Vatikanit II , ende të pranishme, kanë këtë kuptim : të relativizohet, të hollohet me ujë Konkili. Më vjen keq kur ndonjëri rekrutohet në fushatën e qëndresës. Për fat të keq e shoh edhe këtë. Nuk mund të mohoj që ka edhe qëndresa. I shoh dhe i njoh. Janë qëndresat doktrinale. Për shëndetin mendor un nuk i lexoj sitot internet të kësaj të ashtuquajturë “qëndrese”. E di kush janë, i njoh grupet, por nuk i lexoj, thjesht për shëndetin tim mendor. Nëse ka ndonjë gjë shumë serioze më

njoftojnë që t'a di. Është një keqardhje, por duhet të shkojmë përpara. Kur perceptoj qëndresa kërkoj të bisedoj, kur biseda është e mundur ; por disa qëndresa vijnë nga njerëz që besojnë se zotërojnë doktrinën e vërtetë dhe të padisin për heretik. Kur tek këta njerëz, për atë që thonë e shkruajnë, nuk gjej mirësi shpirtërore, un thjesht lutem për ta. Ndjej keqardhje por nuk ndalem në këtë ndjenjë për higjenë mendore”.

Në çfarë reformash mund t'u mbështesim më mirë ?

“Besoj se një nga gjërat për të cilat Kisha ka më shumë nevojë sot dhe ajo gjë është shumë e qartë në perspektivat dhe objektivet baritore të *Amoris laetitia*, është arsytimi. Ne jemi mësuar me “mund të bëhet ose nuk mund të bëhet”. Edhe un, në formimin tim, kam marrë mënyrën e të menduarit “deri këtu mundet, deri këtu nuk mundet”. Nuk e di a të kujtohet ai jezuiti kolumbian që erdhi të na mësojë moralin në “Kolegjin e Madh”; kur u fol për urdhnimit e gjashtë, njëri guxoi të bëjë pyetjen: “A mund të puthen të fejuarit?” Nëse mund të putheshin ! A kuptoni ? Dhe ai tha : “Po, mund të puthen! Nuk ka problem ! Mjaft që të venë në mes një shami”. Kjo është një *forma mentis* për të bërë teologji në përgjithësi. Një *forma mentis* e bazuar mbi cakun. E mbajmë mbi kurriz pasojat.

Çfarë t'u themi (në Shoqërinë) atyre që plaken e mbas tyre shohin më pak njerëz ?

Duke mbajtur parasysh pakësimin e të rinjve dhe fuqive, mund të hyhet në një pikëllim institucional. Jo nuk duhet t'i a lejon vetes. Pikëllimi të tërheq poshtë, është një mbulesë e lagur që t'a hedhin përsipër për të parë se si do të dalësh në krye e që të çon në hidhërim, në zhgënjim. Un pyes veten nëse Saveri, para dështimit të vështirimit të Kinës pa mundur të hynte brënda, ishte i dëshpëruar. Jo, përfytyroj se ai i është drejtuar Zotit, duke i thënë : “Ti nuk e do, pra lamtumirë, shkon mirë kështu”. Ka zgjedhur të ndiqte udhën që i tregohej, që n'atë rast ishte vdekja !..... Por mirë ! Si Saveri në dyert e Kinës shikoni gjithënjë përpara..... E di Zoti vetë !”

Do të donja të na thoshit ndonjë fjalë për temën e shpërdorimeve seksuale. Jemi shumë të prekur nga këta skandale.

“Është pikëllimi më i madh që kisha po kalon. Kjo na shtyn në turp, por duhet të kujtojmë gjithashtu se turpi është një hir injacian.. Pra t'a marrim si një hir e të turpërohemi thellësisht. Duhet

të dashurojmë një Kishë me plagë. Shumë plagë.... Të tregoj një ndodhi. 24 marsi në Argjentinë është kujtesa e grushtit të Shtetit ushtarak, të diktaturës, të *të humburve*, dhe Sheshi i Majos mbushet për t'i kujtuar. Në një ndër këta 24 marse, ndërsa po përshkoja një rrugë, ishte një çift me një fëmijë dy a tre vjeç që vraponte përpara. Babai i tha : “Hajde, hajde këtu.... Kujdes nga pedofilët !”. Çfarë turpi kam ndjerë ! Çfarë turpi ! Nuk e kuptuan se isha arqipeshkvi, isha një prift dhe..... çfarë turpi ! Nganjëherë nxjerrin “çmime ngushullimi” dhe ndonjëri madje thotë : “Shiko statistikat.... të.... nuk e di.... 70% e pedofilëve janë në mjediset familjare, të njohurish. Më pas në palestrat, në pishinat. Përqindja e pedofilëve që janë priftërinj katolikë nuk arrin 2 %, është 1,6 %. Nuk është shumë....” Por është e tmerrshme edhe sikur të ishte një i vetëm nga këta vëllezër tanët ! Sepse Zoti e ka mirosur për të shenjtëruar fëmijë e të mëdhenj, ndërsa ai i ka prishur. Është e tmerrshme ! Duhet dëgjuar se çfarë ndjen një i shpërdoruar apo një e shpërdoruar ! Të premtëve – herë dihet e herë jo – takohem zakonisht me disa prej tyre. Proçesi i tyre është shumë i ashpër, mbeten të asgjësuar. Tregon jo vetëm brishtësinë tonë por edhe, t'a themi hapur, nivelin tonë të hipokrizisë. Është e çuditëshme : dukuria e shpërdorimeve ka prekur disa shoqata të reja, të pasura. Aty shpërdorimi është gjithmonë frut i një mendësie të lidhur me pushtetin, që duhet të shërohet nga rrënjët e tyre të këqia. Ka tre lloj shpërdorimesh që shkojnë së bashku : shpërdorim autoriteti, seksual dhe ngatërresa ekonomike. Në mes është gjithmonë paraja : djalli hyn nëpërmjet kuletës”.

Si e shikoni atë që Shpirti tashmë po e shtyn Kishën drejt s'ardhmes ?

“Merrni në dorë Konkilin Vatikan II, *Lumen gentium*. Duke u folur ipeshkvijve kilianë u kërkonja deklërikalizimin. Ungjillëzimi bëhet nga Kisha si popull i Zotit. Neve Zoti na kërkon të jemi Kishë në dalje, spital fushimi. Një Kishë e varfër për të varfërit ! Të varfërit nuk janë një formulë teorike e partisë komuniste, janë qendra e Ungjillit. Un ndiej se në këtë rrugë po na çon Shpirti. Ka qëndresa të mëdha, por për mua fakti që lindin është shenja se jemi në rrugë të mbarë. Përndryshe djalli nuk do të lodhej të bënte qëndresë”.

**“Corriere della Sera, 15 shkurt 2018
përktheu nga italishtja: Eugen Merlika**

ORIGINALITETI I NJË TRADITE TEOLOGJIKE NË KRISHTERIM

Bashkësia e doktrinës së besimit është një rezultat i sforcimeve të bëra nga të krishterët për t'i kundërshtuar sulmimet e ndryshme, të brendshme dhe të jashtme, të marra gjatë kalimit të shekujve. Doktrina bëhet e tillë që nga fillimet e saj. Kështu, Etërit grekë, si: Atanasio (295-373), Basilio (330-379), Gregorio di Nazianzo (329-390) dhe Atë Gregorio di Nissa (394) i japin rëndësi, Trinisë, personave dhe të qenit njëloj në brendësi, gjë e cila tregohet aktuale përmes mishërimit të Birit dhe

me këshillimin e Efetit (431) e pastaj me atë të Calcedoia (451), me pasojat e monofizizmit e pastaj të monoteizmit (Shenjtji Massimo Rrëfyeti, 662), deri në arritjen e diskutimit të dhimbshëm rreth ikonave, me dispozitë të Giovanni Damasceno (749 ca.). Në lindje, influenza e Agustinit është dështimi relativ i pozicionit të tij në kamp, pikërisht nga hiri hyjnor dhe liria njerëzore, e cila bëri që pyetja të përsëritej shekull pas shekulli. Nga ku del rëndësia e të njohurit të një tradite tjetër,



dhuratës së bërë nga Shpirti i Shenjtë.

Etërve të fesë latine, iu është dashur ta përballonin trup me trup aspektin antropologjik të besimit, përgjatë problemit të hirit dhe të lirisë njerëzore, të ngritur nga monarku Pelagio (354-420 ca.) dhe të marrë pastaj nga peshkopi Giuliano di Eclano (380-455 ca.). Sipas këtij këndvështrimi figura që shndrit është ajo e Agostinos (354-430), i cili i konsumoi forcat e tij të fundit, por pa arritur të realizoi tërësisht objektivat e tij. Veçanërisht, përballë kokëfortësisë së Giulianos, ai theksoi datat e Shkrimit të paracaktuar, të mëkatit fillestar dhe atë që lidhet me epshin.

Asnjë nga dy kontekstet, pothuajse asnjëherë, nuk shpjegon hollësisht. Në lindje, nga dogma trinitariane kalohet tek ajo e krishterimit, përpara

në po të njëjtin vend latin lindor. Do të rikthehemi në këtë pikë.

Më përpara të përpiqemi që të ndjekim hapat sesi u bë e madhe polemika e Lindjes. Me qëndrimet e tij mbi natyrën dhe hirin, sado që kanë qenë absolutisht pozitive aspektet e mësimave të Agustinit, veçanërisht pasardhësit e tij e kanë kthyer agustinizmin, pavarësisht se në brendësi kishte sukseset e veta, në një “ndërgjegje të keqe” të Lindjes, duke përdorur shprehjen e marrë nga e gjithë kjo çështje, të shpikur nga filozofi F. W. Hegel (1770-1831), në një “ndërgjegje të palumtur”.

Interesi për këtë shprehje të ngushtë filozofike është ai i të treguarit të forcës në drejtimin kulturor, të një çështjeje fillimisht teologjike.

Paralajmërimet manifestohen poshtë karolinianëve, përmes tezave të parashikuara nga Godescalco “Guri” (805-870 ca.); më vonë do të shpërthejë në protestantizëm, për të përfunduar në jensimizëm, veçanërisht me figurën e “besimtarit shëndetlig” që do të ishte gjeniali Blaise Pascal, gjemb përballë Voltaire.

“Ndërgjegjja e palumtur”, pra nevoja për të refuzuar të qenit të lumtur, atë që të bën të lumtur, nuk pushon. Përkundrazi, përhapet dhe rrit influencën e saj. Mbase është zhdukur në kohën tonë? A është zhdukur në Kishën tonë? Në të vërtetë është e kundërta, ajo na kërcënon dhe na bën gjithnjë e më tepër të evokojmë sa më pak Zotin, madje edhe në teologji, nga frika për ta rizgjuar; sikur kështu të mund të shërohet.

Këtu mund të futet në lojë ajo linjë doktrinare e cituar më lart, e cila i reziston këtij pesimizmi të fshehur. Më pak e dukshme, nga traditat lindore dhe agustiniane është teologjia romane, e cila nuk ka mundur që të vihet në dukje në një mënyrë të gjallë, sidomos në këto kohë të fundit nuk vihet re zëri i saj. Ajo afirmohet para së gjithash me Ireneon nga Lioni, Ilario di Poitiers e Cesario di Arles, për t'u përhapur pa zhurmë në të gjithë teologjinë.

Vlerat e këtyre autorëve, me ndihmën e një pune të një ritmi të ngadaltë, e kanë mbërritur publikun. Nga Ireneon mund të citojmë “Contro le eresie”, nga Ilaro “La trinia”, nga Cesario “I sermoni e gli Opuscoli”. Mbi këto vepra mbështetemi tashmë për të themeluar pa hezitim një teologji “më shumë sesa lumturinë”.

Ireneo di Lione dhe lavdia e Zotit tek njerëzit

Është i fortë kontrasti mes këtij titulli dhe “ndërgjegjes së palumtur” për të cilën folëm më lart. Të shikojmë sesi e gjitha kjo nuk është një sforcim:

Një misionar i ardhur nga Smirne – në Greqinë jonike – e deri në Lindjen e largët. Në Gallia, në Lio, Ireneon (130-200 ca), shfaqet si një aerolit në historinë dogmatike. Dhe si i tillë, ai është i pari që shkëputet nga lëvizja e fuqishme antikristiane, që u damkos në letrën e Parë dhe të Dytë të Giovannit, të cilat kërkojnë besimin në Zot. U paraqit shumë njerëzor në sulmin ndaj mishërimit “*Janë shfaqur në botë shumë sulmues, të cilët nuk e njohin Jezusin e mishëruar. Ja pushtuesi dhe antikrishti!*” (2 Gv 7), “*Kush është gënjeshtar, përveç atij i cili e mohon që Jezusi është Krishti? Antikrishti është ai i cili mohon Atin dhe Birin*”. (1 Gv 2,22).

Përpara “ndërgjegjes së palumtur”, gnosis, e

cila afirmohet në krishterim duke filluar nga 140, i frikëson, i zhvlerëson dhe i refuzon kushtet e njeriut të mishëruar. I largohet, duke refuzuar që Zoti është krijuesi i kësaj bote të shëmtuar dhe që Fjala është mishëruar. Dhe pandeh, ndërkohë që pas çdo dështimi argumentesh, shpirtërorja e pastër e perfektëve, ndizet në mënyrën më të thjeshtë duke braktisur Krishtin dhe Kishën për çdo “guru”, në çdo pseudogrup.

Ireneon parashtrohet “rregullën e së vërtetës që e ruajmë” e nga ku përqendrohet forca: “*Duke e mbajtur të salduar këtë rregull, edhe pse prezantojnë mësimet e shumta në numër dhe të ndryshme nga njëra-tjetra, bëhet e lehtë për ne që të tregojmë se nuk janë larguar nga e Vërteta. Në fakt, të gjitha këto teori që ekzistojnë, tregojnë që Zoti është një dhe i vetëm, por me anë të perceptimit të tyre të gabuar, njerëzit e ndryshojnë të vërtetën, duke u treguar kaq mosmirënjohës në raport me Atë që i ka krijuar. Ato e zhvlerësojnë veprën e krijuar nga Zoti dhe komprometojnë shpëtimin e tyre, duke qenë akuzues shumë të rreptë të vetvetes dhe dëshmitarë të rremë*” (Contro le eresie, I, 22,1). Rregulli është një i vërtetë dhe i provuar edhe jo një fantazmë pseudo-teoro-logjike. E ekzaminojmë pra provën, për të verifikuar nëse ju është infiltuar një spunto minimale e ndërgjegjes së keqe. Dhe ja argumentet:

Para së gjithash, Ireneon ia ndalon vetes, ashtu siç edhe të gjithë të tjerëve, të mendojnë çfarëdolloj gjëje për Zotin, që vetë Zoti nuk i thotë me Fjalën e tij, si është marrë nga Bibla dhe që anti të krishterët nuk e përdorin, duke e deformuar sipas mënyrës së vet. Njeriu nuk mund t'i japë asgjë Zotit dhe përmes kësaj “asgjëje” i vijnë të gjitha të mirat dhe vetë njohja e të gjitha të mirave. Është Zoti ai i cili na jep gjithçka, njeriu merr gjithçka. Kjo e vërtetë është si një rikthim, që artikulon të gjithë veprën e Ireneos. E vërteta është e qartë, frustruese pa dyshim për krenarinë njerëzore, veçanërisht një mënyrë e lirë për t'u besuar.

Në këtë “asgjë” formulohet kjo që po vijon: e gjithë Bibla, në fjalët e saj, në librat e saj, me kontradiktat dhe me ndryshimet thelbësore të dy momenteve: Atike dhe të Testamentit të Ri, bëhet si e tillë dhurata e dhuratave dhe është një qëllim i dorës së dytë për t'i marrë këto dhurata për t'u bërë unik, ku vetë ndërgjegjja e tyre manifestohet si dhuratë.

Kështu Ireneon rilexon të gjithë Antikitetin dhe Testamentin e Ri, për të shikuar nëse është thënë ndokund që Ati nuk është Krijuesi dhe se Fjala nuk u bë njeri sipas Shkrimeve. Por, kjo nuk ndodh në

asnjë pjesë. Këto imazhe formojnë librat III dhe IV të veprës së Ireneos dhe është karakteristike mënyra e tij e të argumentuarit. Këto i transmetojnë lexuesit shumë siguri. Manifestojnë ndryshime të stilit dhe të propozimit dhe me këtë një dinamizëm të qenësishëm të realitetit, i cili u soll nga Fjala. Kështu, vetë Jezusi afirmon pozitivitetin e ligjit, për zhvillimin e njeriut, por pengon që ligji të mbyllet në vetvete, falë profetizimit, i cili hap një rrugë shpëtimi, pavarësisht të gjithë veprave të pandershme, duke treguar në këtë mënyrë, që aleanca është e mundur që të shpëtojë vetë aleancën. E kjo çel në vetë veprën e të njëjtit Jezu.

Mënyrat sesi duhet ta trajtojmë dramën e kapitullit 3 nga Fillesat janë domethënëse.

Ashpërsia e mëkatit nuk është aspak injoruar, ashtu siç nuk është injoruar drejtësia e Zotit në mirësisë dhe mirësia e tij në drejtësinë e tij; nëse këto nuk mbahen bashkë, çdo gjë bëhet e pakuptimtë. Por, i këshillojmë të gjithë ata që kanë rënë pre e “ndërgjegjes së palumtur” që të lexojnë atë që Ireo i thotë Adamit dhe Evës, rikapitalizimit të Adamit në Krisht dhe të Evës në Maria (III, 21 dhe 23). Paraardhësit tanë nuk ishin veçse dy adoleshentë të vegjël, naivë dhe të gënjer, që Ati i tyre i ka ndëshkuar, sigurisht, por që ka lidhur tashmë me sukses të plotë atë që është Biri i tij dhe biri i tyre, mish i mishit të tyre. Si të mos e thërrasim atëherë në këtë përmbledhje dhe atë që quhet “felix culpa” e liturgjisë së Pashkëve?

Gnostrikët kishin kështu padyshim të drejtë për të mos i dhënë njeriut të bërë nga mishi

mundësinë minimale që të hyjnë në kontakt me Zotin, duke cituar tekstin e Rm 8,8: “*Ato që e lënë veten të dominohen nga mishi, nuk mund të pëlqehen nga Zoti*”. Por, nuk e marrin në konsideratë atë që do të vinte më vonë: “*Ju, nuk jeni nën ndikimin e mishit, por të Shpirtit, që nga momenti kur Shpirti i Zotit banon në ju*” (Rm 8,9). Ato nuk e kanë mbledhur të gjithë të vërtetën sepse, duke pohuar pamundësinë e trupit për të takuar Zotin, përfundojnë duke e ndaluar Zotin të vijë që të banojë ndër ne. Ireneo, i cili nuk heziton aspak që të qortojë ashpër delet e tij të humbura, veçanërisht kur analizon pa *humour* fantazmagoritë dhe di shumë mirë që të lutet për to.

Me Ireneon, gjithçka nuk shkon vetëm në drejtim të lumturisë, por edhe në drejtim të

lavdisë, që i shton lumturisë një dimension plotësie dhe të bashkëndarjeje. Mesazhi i tij nuk është vetëm teologjikisht pozitiv, por ai lartëson thellësisht lidhjen mes Zotit dhe njeriut, që është zemra e teologjisë. Dy thënie

të Ireneos përgatisin formulën që e ka bërë të njohur, me qëllim. Në librat III dhe IV, në plan të parë është çështja e “lavdisë së njeriut”: “*Sepse lavdia e njeriut është Zoti, nga ana tjetër marrësi i veprës së Zotit, është i çdolloj njohurie dhe fuqie, është vetë njeriu*” (III, 20, 2); “*Lavdia e njeriut është këmbëngulja në shërbim të Zotit*”. (IV, 14, 1).

Atëherë mund të mbizotëroi përfshirja e mrekullueshme e kësaj lavdie të njeriut në vetë Zotin: Pra, Biri është detektori i Atit, që nga fillimi, ai është me Atin që nga fillimi dhe i ka treguar mbarë botës, në kohën e duhur edhe për përparësinë e tij, vizionet profetike, larminë e dhuratave, prokurorët dhe lavdinë e Atit, në mënyrën e një melodie të kompozuar në mënyrë harmonike. Ku ka kompozim, aty ka melodi: ku ka melodi, aty është koha e duhur, ku është koha e duhur, aty ka përparësi. Prandaj Fjala bëhet shpërndarësja e lavdisë atërore dhe përparësia e njerëzve, për të cilët ka bërë kaq shumë gjëra, duke i treguar Zotin njerëzve dhe duke ia prezantuar njerëzit Zotit, duke i ruajtur e shikuar në mënyrë të padukshme nga Ati, deri atëherë kur njeriu nuk bëhet më përbuzësi i Zotit dhe të kishte gjithnjë një pikë drejt së cilës mund të kishte progres, por në të njëjtën kohë Zoti tregohet i dukshëm për njerëzit, deri në kohën kur



njeriut që i mungon Zoti, të mos mund të mohonte kurrë ekzistencën e tij. Në fakt, “*Lavdia e Zotit është njeriu i gjallë dhe jeta e njeriut si edhe vizioni i Zotit*” (Contro le eresie, IV, 20, 7).

Këtu nuk kemi një formulë të izoluar, por çelësin e koherencës, nga ku shfaqet bukuria, nga pikëvështrimi letrar, bashkë me të vërtetën e saj. Nga ato që e kanë ndjekur, dallojmë Tertullianon (160-220ca) e Origene (180-253 ca). Ireneo thekson, me një stil të madh, shfaqjen e parë të “ndërgjegjes së palumtur”. Duhet që të nënvizojmë këtu që doktrina e lavdisë, është në të njëjtën kohë, siç është e vënë re nga studiuesit, ajo e një Ungjilli me liri të plotë të Krishtit në jetën tonë. Që nga fillimi i këtij prezantimi kemi theksuar një mundësi të tretë, e cila është prezantuar në atë që është bërë një çështje depërtuese në zonat latine perëndimore. Ajo rishikon raportin e krijuar mes lavdisë hyjnore dhe lirisë njerëzore; ajo rrjedh qartësisht në fillimin e shekullit V. Pelagio, preokupohet për entuziazmin shpirtëror që kishin besimtarët e tij, të cilët nuk i kushtojnë më rëndësi lavdisë së Hyjit.

Cesario di Arles, praktikon me gjallëri argumentimin me kundërshtarët. Përdor këtë tip argumentimi vetëm në broshurën mbi “natyrën dhe lavdinë”, duke i hequr citimet pro apo kundër njëritjetrit në një lojë të këndshme, por të paqëndrueshme, nga e cila del vetëm ekzistencialja “*Thellim i pasurisë, i njohurisë dhe i njohjes së Zotit*”! (Rm, 11, 33).

Sigurisht, fjalori i lavdisë, në statusin aktual të kërkimit mbi Cesarion, nuk duket që është e vetmja gjë për të. Ai është mjaft i preokupuar, por a mund të jesh kaq shumë? Komenti që ai i bëri Apocalisit, mjaft origjinal, nuk trajton katastrofa të teologjisë: e gjithë lufta është e përqendruar në luftën e Kishës, në botë, por mbi të gjitha në vetvete, dhe aty, mbi fitimin e tij falë të gjithë bijve të tij. Vetëm një analizë finale e 19 kapitujve, evokon “lavdinë” (IV). Por e dhjeta, në qendër të veprës, përfundon kështu: “*Ne të krishterët jemi 'të shënuar' që na fillimi i botës*”. Zoti vetë denjohet që t'ju hyjë garant.

Një ndihmë vëllazërore për betejat tona aktuale

Duhet që të kompletojmë përshkrimin e traditës galo-romake nga shumë pikëvështrime. Veçanërisht, duhen që të nënvizohen tre: fillimisht, fakti që këto autorë bashkëpunojnë në një lidhje shumë të afërt me Romën; pastaj, që janë shumë të hapur dhe të lidhur ngushtësisht me orientalizmat;

në fund themi se ato janë mbrojtës të patrembur të lirisë njerëzore-hyjnore.

A kemi treguar në këto faqe një histori të së kaluarës, që mund ta bënim edhe më të bukur? Duhet të përgjigjemi: “Jo”! Është historia jonë aktuale, ajo që jemi duke e rijetuar. Në të vërtetë është paraqitur një reflektim teologjik-filozofik, në të cilën tregohet që nuk duhet të heqim dorë lehtë, në fakt, ne nuk duhet që të ndalojmë të ngriturin e kokës lart. Në 2018 “kjo portë e Ades”, kjo “ndërgjegje e palumtur”, 100 herë turbullon jo vetëm popullin e Zotit, por edhe botën perëndimore, pra jo edhe aq të krishterë në krahasim me botën tonë. Ne duhet t'i përshëndesim të gjitha vështirësitë e së sotmes, në këto zonë të hijezuara. Bëj që këto zona të ndriçohen, në të vërtetë!

E është pikërisht aty që është manifestuar edhe në shekujt tonë XX dhe XXI, një rezistim i fortë në popullin e krishterë. Sigurisht, Ireneo, Ilario dhe Cesario nuk e kanë braktisur inteligjencën e besimtarëve për të kaluar tek ajo e historianëve të Kishës. Por në periudhën e Koncilit Vaticano II, është mundësuar rijetimi i veprave të Etërve, që përpara ishin gati të panjohura, ato kanë arritur që të ndihmonin Agostinon e pakapshëm: si për shembull grekët dhe Ireneo. Këtij të fundit, i janë kushtuar falënderime dhe botime me baza shkencore, luftëtarë të vërtetë të doktrinës novatore të Këshillit. E gjitha kjo ndodh sot. Është aktuale që linja doktrinare galo-romake, akoma mund të riformohet nga luftëtarë të tjerë të vendosur. Beteja jonë është beteja e tyre. Modernë në rizbulimin e tyre, ato nuk shpikin asgjë, jemi ne ato që jemi duke i rizbuluar, pasi na shërbejnë për çështjen tonë.

Etërit, në ndeshjet tona dhe fitoret, nuk janë vetëm vëllezërit tanë, por vëllezërit e vërtetë tanë. Me to, ne dimë që nuk është e kotë të kërkojmë që të sjellim ndër mend, gjithnjë e më shpesh, këtë “portë të Ades”, për të cilën kemi folur këtu. Me to, rimarrim nga Zoti dijen dhe kurajën që na duhet, në këtë detyrë shpëtimi. Me to, mund të reprojektojmë në Trinitet miken e parë të njerëzimit, realizmin e një ambicieje hyjnore për vetë njeriun: lavdinë e tij, gjininë e tij të vetme drejt së mirës.

Material i përkthyer nga revista kulturore – fetare:

**Ireneo, Ilario, Cesario Dominique
Bertrand S.I**

“La civiltà cattolica”.

Përktheu: Bernardina Shahini

Leonora Laçi
Shkodër

E VËRTETA SI I SHPËTOJ SIGURIMIT MONS.DR. ZEF OROSHI !

Qëllimi i këtij shkrimi është që të shpjegoj të vërtetën e arratisjes në mal të Mons.dr.Zef Oroshit, që për nga mënyra si u realizua u duk e pabesueshme. Duke hedhur hipoteza të ndryshme deri dhe në përbaltesjen e Dom Zef Oroshit.

Historia dhe peripecitë e jetës së Mons. dr. Zef Oroshit i lindur në Kaftall të Oroshit, Mirditë në 1912 e largët , si bashkohës i shumë ngjarjeve vendimtare të kombit shqiptar deri sa mbylli sytë në vitin 1989, duhet të jetë pjesë e historiografisë sonë, aktiviteti dhe kontributi i tij kombëtar duhet të shënohen me germa të arta për të mos u harruar.

Ardhja e komunizmit.

Fitorja e komunizmit në vitin 1944 në Shqipëri do jetë vetëvrasja më e madhe që i bënë shqiptarët vetës, për ata që e pranuan atë. Dom Zefi bën pjesë në ato njerëzit që nuk u pajtuan asnjëherë me fitoren e komunistëve, ai nuk e pranoi as në atdhe por as në Shtetet e Bashkuara të Amerikës fitoren dhe pushtetin e komunistëve.

Dom Zefi në fillim të viteve 50' u tregua mjaft aktiv në zonën e Mirditës, kjo ishte periudha më e ashpër e represionit shtetëror ndaj armiqve të pushtetit. Si një antikomunist i vendosur ai i qëndroi besnik atdheut dhe fesë.

Sigurimi po ushtronte një presion të madh mbi popullsinë civile, duke qenë se dhe iniciativa anglo-amerikane për të shembur komunizmin në Shqipëri, kishte ndikuar që lufta e klasave brenda vendit të ishte më

e ashpër, konkretisht lufta kundër armiqve të pushtetit të cilët që në 1945 kishin mbushur burgjet dhe kampet e internimit duke u torturuar në format më çnjerëzore ngjashëm me kampet e nazizmit, dhe me metodat e tyre. Dom Zefi përveç detyrës fetare, duke parë çdo ditë se çfarë i bëhej popullit të tij Mirditas zgjodhi të ishte aleat i tyre. Ai bëri përpjekje për kryengritje por që pa sukses, pasi komunistët tashmë kishin përgatitur terrenin dhe njerëzit për të zbuluar veprimtarinë e antikomunistëve. Aktiviteti i tij ra në sy të sigurimit dhe qeverisë së E.Hoxha duke kërkuar dhe arrestimin e tij me çdo kusht.

Pa nënshtrimin e Veriut e konkretisht Mirditës, komunistët e kishin të qartë që pushtetin nuk mund ta kishin të plotë. Në një qarkore që Ipeshkvi Bernardin Shllaku i dërgon dioqezave (shkruar nën torturë nga sigurimi) tregohet sesa bujë kishte bërë arratisja e Dom Zefit dhe jo vetëm sigurimi ishte në kërkim të tij por ishte ngritur dhe një komision kërkimi i përbërë nga Dekani i Tiranës, Dom Mark Dushi, dhe Administratori Dioqezan i Lezhës Dom Ndoc Sahatçija.

Madje vet D.Ndoc Sahatçija në nëntor të vitit 1952 merr rugën për në Veri të Shqipërisë për ta kërkuar vetë (referuar nga libri i Markus W. Peters, Përballjet e historisë së Kishës Katolike në Shqipëri 1919-1996). Për arratisjen e Dom Zefit është shkruar dhe në studimet “Dosjet e Diktaturës” e studiuesit Pjetër Pepa dhe në monografinë “Mons.dr.Zef Oroshi –Një jetë e shkrirë për fe e atdhe” të studiuesit dhe Sekretarit të Lidhjes së III të



Prizrenit, z. Tomë Mrijaj (SHBA) dhe në veprën e Nikollë Melyshit, “Ngjarje Historike, të ndime, të pame e të jetueme”.

Momenti i arratisjes së Mons.dr. Zef Oroshit është kthyer në një legjend, por për ta bërë reale dhe të mos mitizohet më tej me këto fakte, pata një bashkëbisedim me nipin e Mons.dr. Oroshit, Prend Gjokën, i cili më rrëfeu të vërtetën sesi dom Zef Oroshi i kishte shpëtuar arrestimit dhe ishte fshehur në mal deri sa largohet fillimisht në Evropë e më pas në tokën e premtuar, SHBA.

Amerika u bë atdheu i dytë për të dhe veprimtarinë e tij, atje la gjurmë me themelimin e Kishës së Parë Katolike Shqiptare, kjo tregon se i shërbeu më mirë atdheut larg tij duke qenë se Shqipëria u kthye në një burg të madh për intelektualët dhe ndrydhi jo vetëm dëshirat për tu arsimuar por ndrydhi dhe burgosi dhe mendimet për tu shprehur e për të arritur në jetë.

Ai (Prend Gjoka) rrëfen se halla a e tij (motra e dom Zefit, Lukja e cila përjetoj kalvarin nëpër burgjet e internimit, dhe pas rënies së komunizmit ka jetuar në shtëpinë e nipit deri ditën që mbylli sytë) kishte qenë personi i fundit që Dom Zefi kishte takuar para se të arratisesh në mal.

Por si ndodhi ngjarja?

Ishte janari i vitit 1952 (viti është i diskutueshëm mund të jetë dhe 1951) Dom Zefi si famullitari i Ungrejt, do zhvillonte meshën e së Dielës në Kishën “Shën Maria Magdalenë”.

Kisha e fshatit kishte një distancë prej 50 metrash me Qelën. Në Kashnjet dhe në fshatin Ungrej por dhe fshatrat përreth gëzonin respekt për meshtarin dhe është meritë e fshatit Ungrej që realizuan arratisjen e dom Zefit që të mos binte në duart e sigurimit të cilët bënë të pamundurën të informojnë dom Zefin se Kisha ishte e rrethuar nga forcat e Sigurimit. Urdhri i arrestimit kishte ardhur nga Mehmet Shehu.

Sigurimi po priste që mesha të përfundonte dhe prifti të dilte i fundit për ta arrestuar, e ata vëzhgonin nga dera kryesore daljen e popullit. Plani ishte që të arrestohej në momentin e daljes së popullit nga kisha dhe Dom Zefin ta arrestonin që të mos mund të kundërpërgjigjej.

Dom Zefi shfaqet se nuk ndjehet mirë dhe pa zhurmë lë meshën dhe del nga dera sekrete mbrapa Kishë, dhe shkon tek Qela që ishte sipër Kishës e takon të motrën e cila i shërbente, Luken. Ndërkohë që ajo gatuante dreken, dëgjon dom Zefin që e thërret: “*Luke, Luke unë ika*”, koha nuk i premtoj që të përshëndetej më tej, dhe Lukja duke e kuptuar situatën e sheh Dom Zefin që kapërcen murin rrethues rreth 2 metra të lartë për të humbur gjurmë në pyllin me gështenja. Në këtë kohë ajo është kujtuar që të marr pardysyn dhe ja ka hedhur matanë murit duke i thënë “*Paq Zotin me vedit*”.

Ndërkohë populli në kishë po priste përfundimin e predikimit të priftit. Dhe panë që diçka nuk shkonte dhe prifti nuk po dilte tek elteri duke qëndruar dhe pas orës 12:00, ku pretendohet që mesha të përfundonte. Në këtë kohë forcat e sigurimit dyshuan se pse populli nuk po dilte nga Kisha. Kështu ata vendosin të hyjnë në Kishë dhe ngelën të befasisur kur nuk kanë gjetur priftin aty.

Populli e kuptoj që sigurimi kishte ardhur për

arrestimin e Dom Zefit dhe ky ishte arratisur. Pasi sigurimi bëri një kontroll të shpejt të kishës, u nisën për tek Qela, aty pyeten Luken e cila i jep përgjigje se: “*Dom Zefi po jep meshë*”-mbyll rrëfimin e tij nipi i Dom Zefit, Prend Gjoka.

Dom Zefi në mal bashkohet me grupet antikomuniste, ku do qëndroj për tetë muaj deri sa kaloi në Kosovë e cila ishte pjesë e Federatës Jugosllave, me gjithë vështirësitë dhe i plagosur kalon në Mitrovicë e nga aty sëbashku me Atë Daniel Gjeçajn O.F.M, Atë Ambroz Martinin O.F.M, dhe Nikollë Kimzen, pas garancive që i dhanë Dera e Gjomarkut e personalisht Kapidan Ndoi, shkojnë në Itali. Nga aty, në vitet '60 Mons.Oroshi nisesh drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Për veprimtarinë në male të Dom Zef Oroshit na jep të dhëna Bep Kuqani ish i burgosur politik për shumë vite, në një shkrim të botuar në vitin 2009, i cili thotë: - *E tash në lidhje me një shënim të Z. Ndue Melyshi, citue në faqen 53, ku thuhet: “Meqenëse ishte Komiteti klandestin, nuk mund të zgjidhej kryetari me vota të lira të popullit, prandaj antarët në brendësinë e Komitetit caktojshin një kryetar...”, dishroj të plotësoj këtë mendim, tue shtue, se në “brendësinë e këtij Komiteti”, kje zgjedhë si Kryetar Dom Zef Oroshi dhe Sekretar Jak Perjaku, i cili, kje vra në mal, në përpjekje me forcat e ndjekjes të Sigurimit. Këtë ma ka thanë përveç të tjerëve, që do t'i permendi ma poshtë, edhe vetë i vëllai: Gjon Perjaku, që u kap n'atë përpjekje, i plagosun randë dhe me të cilin kam ndejtë në burgun e Burrelit. Veç kësaj, kam pasë rastë me njohë personalisht edhe katër antarë të këtij Komiteti, nga të cilët per Karlo Çoben, avokat, i biri i Ndoc Çobës, që ka kenë Kryetar i Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar dhe Sulë Hafizin, Kryemyfti i Lezhës, nuk e kam ditë se ka kenë Antar i Komitetit të Maleve; ndërsa për Haki Bushatin, i vëllai i ish – Kryeministrit Maliq Bushati, që u pushkatue bashkë me At Anton Harapin O.F.M, dhe Lef Nosin dhe Ndreka Kakarriqin e kam ditë dhe, edhe këta më kanë thanë se “kena pasë për Kryetar Dom Zef Oroshin”.*

Haki Bushatin e kam njoh vetëm për një periudhë të shkurtë kohe në burgun e Tiranës; ndërsa Ndreken e kam njohë qysh se kam kenë në moshë adolishente, se ka kenë mësues në Kolegjin Saverian, kryetar i Shoqatës “Rrethi Don Bosco” (krijue nga At Pjetër Meshkalla); kam ndejt në burg të Burrelit, mbasi kje denue 17 vjet si antar i atij Komiteti, i arrestuem në Lezhë, vetëm pak muej mbasi kishte fillue punën si avokat. Miqësinë e kena vazhdue edhe mbas daljes nga burgu, deri në ditën që vdiq. (...) Për Dom Zef Oroshin, duhet ditë edhe kjo: Qysh nga dita e arratisjes, që hoqi veladonin e doli në mal, e deri që iku në Jugosllavi, banorët e Mirditës dhe të malësisë së Lezhës e kanë njohë ma fort se prift, si Kryetar të Komitetit të Maleve, si organizator i “Çetave të Shpagimit”, si luftëtar shumë trim dhe si antikomunist i vendosun” -shkruan në shkrimin e tij Bep Kuqani.

Mons.dr.Zef Oroshit i prehen eshtrat në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe është hedhur diskutimi për kthimin e eshtrave në atdhe por diaspora e SHBA dhe miqtë e tij kanë qenë të mendimit se-“*Ai bëri historinë atje dhe atje duhet të vazhdoj të prehet i qetë*”.

**SHQIPËRIA DHE SELIA E SHENJTË:
NË KOHËN E GJERGJ KASTRIOTIT SKËNDERBEUT (1444-1468)**



Në emisionin e njëzetë të rubrikës, mbështetur kryesisht mbi veprën me titull “Shqipëria e Skënderbeut dhe Papët, për mbrojtjen e perëndimit të krishterë (1444-1468)”, të arbëreshit Alessandro Serra, vijimi i marrëdhënieve të Skënderbeut me Selinë e Shenjtë, në fundin e papnisë së Kalistit III. Folëm, në emisionin e kaluar, për vlerësimin e lartë të Papës Kalisti III për Skënderbeun, gjithnjë në rritje. Në rritje, edhe ndihmat. E, për fat të keq, edhe ankthi për fatet e Shqipërisë, që po kërcënohej serish nga një ushtri e fuqishme. Beteja kishte filluar e Papa druhej shumë se këtë herë Kryetrimi do të pësonte disfatë. Tepër fitore kishte shijuar! E kishte fituar tepër lavdi, në krye të një populli të vogël, deri asokohe, të papërfillur. Një parandjenjë e kobshme e kishte pushtuar vetëm duke menduar se as Skënderbeu e as ushtarët e tij, nuk do të mund të shpëtonin, mbasi do t'i pengonte Adriatiku. E në këtë gjendje tronditëse, shpejtoi - gjithnjë duke shpresuar se do ta ndihmonte Skënderbeun - të vinte në dispozicion të tij flotën e vet, të ankoruar në

Lindje, duke e njoftuar, njëkohësisht, për këtë akt”.

Më 17 shtator 1457 Papa i shkruante për këtë situatë kardinalit Sant'Angelo, duke shpresuar se Skënderbeu do t'i mundte edhe këtë herë turqit. Shpresa e Papës u bë realitet. Ankthi, që e kishte pushtuar e parandjenjat për mundjen e Skënderbeut, u shndërruan në parandjenjën e fitores. Atëherë Kalisti u ul e i shkroi Skënderbeut një letër, që datohet 17 shtator 1457. Në të përshkruhet si gjendja e tij shpirtërore, ashtu edhe shpresat për një fitore të re. E nëse Papa shkruante, Skënderbeu vijonte ndeshjen me një ushtri turke prej 50 mijë vetash, që kishte arritur në verën e vitit 1457, nën komandën e tradhtarit Hamza. Skënderbeu kishte arsye të shqetësohej, sepse Hamzai i njihte mirë si taktikën, ashtu edhe qafat, shtigjet e fortesat e të ungjit. Nuk ishte e rastit që Sulltani i kishte besuar komandën e kësaj ushtrie të fuqishme, së cilës Gjergji mund t'i kundërvinte vetëm 12-15 burra, të mbështetur edhe nga 5 mijë aleatë. Përballë kësaj ushtrie, Kryetrimi shqiptar ndoqi pak a shumë taktikën e Betejës së Torviollit. Sapo u duk ushtria turke, ajo e Skënderbeut u vu në ikje, në dukje e tmerruar e pa asnjë shpresë.

Pastaj, kur ushtarët e Hamzait, të lodhur nga ndjekja, ngulën kampin në fushën e Albulenës, pranë lumit Mat, Kastrioti u lëshua papritmas mbi ta, duke bërë një nga kërditë më tragjike që qe parë gjatë betejave të tij. 30 mijë turq mbetën në fushën e përgjakur të kësaj beteje

Ishte 7 shtatori i vitit 1457. Vetë Hamzai ra i gjallë në dorë të Gjergjit, i cili nuk e kaloi nën teh të shpatës, por e mbylli në burgjet e Mbretit të Napolit, ku kishte mjaft kohë të lirë që të pendohej për tradhtinë e tij të shëmtuar, ambicioze!

Lajmi mbi këtë fitore të lavdishme të Kastriotit, që arriti në Romë më 24 shtator 1457, e mbushi me gëzim botën e krishterë e, posaçërisht, Papën, që e kishte pritur me frymë profetike, në heshtjen e Qytetit të Amshuar. Kardinali Piccolomini, i cili do të ulej mbas pak në fronin e Shën Pjetrit me emrin Piu II, e regjistroi kështu, shkurt, ngjarjen e madhe: “Shqipëria vijon të na dhurojë fitore”!

SHËN PATRIKU (MAGONUS SUCATUS PATRICIUS) IPESHKËV DHE PAJTORI I IRLANDËS (385-461)



Kisha e përkujton Shën Patrikun, ipeshkëv. Lindi rreth vitit 385 në Angli përkatësisht në Skotlandë nga prindërit krishterë. Në pagëzim japin emrin Magonus Sucatus Patricius. Babën e kishte të shuguruar xhakon dhe më vonë edhe shugurohet për meshtar. Fillimisht Patriku kalojë një jetë të lehtë që nuk u interesuar as për shkollë, për dije dhe fe. Kur i kishte 16 vjeç, piratët Irlandës e zënë rob dhe disa mija tjerë, që çuar në Irlandë dhe i shesin si skllavër. Pronari i Patrikut e çoi për t'i kullosë delet. Pranë tufës së deleve në shkretëtirë, në vetmi si dhe në skllavëri i afrohet Zotit. U lutë shumë bë bënte pendesë. Pas 6 viteve skllavërie, dëgjojë një zë se do të çlirohet. Pasi e rifitoi lirinë, kthehet në shtëpi vet në Britani. Pastaj shkon në Gali përkatësisht në qytetin Auxerre dhe nën udhëheqjen e ipeshkvit asaj kohë Shën Germanit studio teologjinë dhe shugurohet për xhakon pastaj meshtar. Pastaj, i zgjedhur ipeshkëv i Irlandës, me zell të madh e shpalli Ungjillin madh në Evropë.

Selinë ipeshkëvnore e themeloi në Armagh në Ulster, ku sot është selia e kardinalit dhe rimatit të Irlandës. Vdiq në Down (në Irlandën e Veriut) më 17 mars 461. Shën Patriku ishte mbrojtësi nga kafshimi i gjarpërinjve. Sot Shën Patriku nuk është vetëm mbrojtës (Pajtori) i Irlandës, por edhe Irlandezeve në Amerikë, (është e njohur Katedralja e New Yorkut) pastaj pajtori i Nigerisë dhe mbrojtës i inxhinierëve si dhe mbrojtës nga gjarpërinjtë.

Përndryshe është festa nacionale e Irlandës, kremtohet edhe në SHBA, Australi etj, më 17 mars.





At Giuseppe Valentini

Studime dhe tekste
për lindjen e krishterë


*Plejad,
Tiranë, 2010*



Farida Ramadani

Shkodra në 12 vje

Fidani - Prizren 2016



Dom Ndoc Nikaj

Kujtime të një jete së kalume

*Onufri
Tiranë 2016*

KUMBONA E SË DIELLËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë